

RAPORTI VJETOR

20

AGJENCIA SHQIPTARE E
ZHVILLIMIT TË INVESTIMEVE


24

WWW.AIDA.GOV.AL



Albanian Investment Development Agency
Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve

RAPORTI VJETOR



Albanian Investment Development Agency
Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve



TË JETËSOJMË IDE STRATEGJIKE

Lexues të dashur

Qëllimi i Agjencisë Shqiptare të Zhvillimit të Investimeve (AIDA), është të kontribuojë kundrejt zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik të vendit, nëpërmjet nxitjes, tërheqjes dhe promovimit të të gjitha investimeve vendase dhe të huaja.

Motoja jonë është **TË JETËSOJMË IDE STRATEGJIKE**, duke u shndërruar në partnerin dhe udhërrëfyesin e të gjithë investitorëve të interesuar për të qenë pjesë e rrugëtimit të zhvillimit të tyre dhe atë të Shqipërisë.

Mbështetja jonë kryesore, gjithashtu konsiston në zhvillimin e biznesit shqiptar, për ta bërë atë më konkurrues në tregun vendas dhe në veçanti në tregun e huaj, nëpërmjet zhvillimit të ideve të reja në biznes, si edhe nxitjes së inovacionit.

Ne besojmë fort në vlerat si 'fuqia e diversitetit' dhe 'perspektiva strategjike' duke asistuar dhe mundësuar rritjen e investimeve frytdhënëse për ekonominë e vendit tonë.



Ne e vlerësojmë sinergjinë mes 'udhëtimit' dhe 'destinacionit' dhe nëpërmjet asistencës sonë të specializuar synojmë që nga pika ku ndodhen idetë/projektet dhe subjektet shqiptare e të huaja të arrijnë tek destinacioni, përkthimi i të cilit është një numër i madh investimesh në vend, zgjerimi i biznesit vendas në tregjet e huaja, emri i vetëm i të cilit është

**ZHVILLIM I QËNDRUESHËM
GJITHËPËRFSHIRËS EKONOMIK.**

Le të zgjerojmë artin e së mundurës së bashku, duke u bërë palë në rrugëtimin e zhvillimit ekonomik të vendit tonë.

Laura Faro

Drejtor Ekzekutiv i AIDA



Tabela e PËRMBAJTJES

| | | | |
|--|----|--|----|
| Profili i AIDA-s | 01 | Ndërmarrjet mikro, të vogla dhe të mesme | 20 |
| AIDA në ushtrim të funksioneve të veta | 05 | Komunikimi dhe imazhi publik i institucionit | 31 |
| Investimet strategjike | 17 | Burimet njerëzore dhe buxheti | 38 |

PROFILI I AIDA-S

Misioni

Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve ka për mision të rrisë konkurrueshmërinë e sektorit privat, të forcojë potencialin eksportues të vendit, të promovojë mbështetjen e investimeve të huaja të drejtpërdrejta në Shqipëri, si dhe të promovojë potencialin turistik të vendit.

AIDA maksimizon investimet e brendshme dhe të huaja, nëpërmjet krijimit të iniciativave ndihmuese rrit aftësinë konkurruese të ndërmarrjeve në Shqipëri, përmirëson kapacitetet teknologjike dhe rinovimin e tyre me qëllimet e kombinuara që të rris investimet e huaja direkte, të forcojë kapacitetet e biznesit shqiptar, si edhe të ndërtojë një imazh të denjë të Shqipërisë me fokus tërheqjen e investitorëve të ndryshëm.

Funksionet kryesore të AIDA-s

Veprimtaria e Agjencisë përqëndrohet, kryesisht, në:

- Lehtësimin dhe mbështetjen e investimeve të drejtpërdrejta në Republikën e Shqipërisë.
- Rritjen e aftësisë konkurruese dhe inovative të Ndërmarrjeve të Vogla e të Mesme.
- Nxitjen dhe ndihmën ndaj eksporteve të mallrave e të shërbimeve.
- Tërheqjen dhe nxitjen e investimeve strategjike, vendase dhe të huaja.
- Promovimin e Shqipërisë në komunitetin e investitorëve dhe prezantimin e mundësive për investim, pranë investitorëve potencialë apo ekzistues.

Aktualisht, AIDA strukturohet në pesë drejtori:


- Drejtoria e Investimeve Strategjike
- Drejtoria e Investimeve të Huaja Direkte, Partneritetit & Kërkimit
- Drejtoria e Projekteve, Ndërmarrjeve të Vogla dhe të Mesme dhe Eksporteve
- Drejtoria e Marketing
- Drejtoria e Financës, Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse

Kuadri ligjor i Agjencisë

AIDA funksionon në bazë të kuadrit ligjor të posaçëm:

- Ligjit nr. 10 303, datë 15.7.2010 “Për krijimin dhe mënyrën e organizimit e të funksionimit të Agjencisë Shqiptare të Zhvillimit të Investimeve”,
- Statutit të AIDA-s, miratuar me Vendim të Bordit Drejtues të AIDA-s nr. 1, datë 08.11.2024, “Për disa ndryshime në vendimin nr. 3, datë 17.06.2019 të Bordit Drejtues “Për miratimin e niveleve të pagave dhe të organikës të Agjencisë Shqiptare të Zhvillimit të Investimeve (AIDA)” është miratuar struktura e re e AIDA-s.
- Rregullores së Brendshme të AIDA-s, miratuar me vendimin e Bordit Drejtues të AIDA-s nr. 11, datë 21.07.2011;

Organigrama



Drejtoria e Investimeve Strategjike

Qëllimi i Drejtorisë së Investimeve Strategjike është të identifikojë, vlerësojë dhe ekzekutojë mundësitë e investimeve në përputhje me qëllimet afatgjata nga aspekti ekonomik dhe social i vendit, me ndikim në rritjen, përfitimin, qëndrueshmërinë e këtyre investimeve dhe krijimin e vendeve të punës. Misioni i kësaj drejtorie është të krijojë vlerë përmes investimeve të larmirshme, të zbusë rreziqet dhe të promovojë inovacionin duke iu dhënë përparësi interesave të palëve të interesuara dhe parimeve etike.

Funksionet kryesore:

- Formulimi dhe zbatimi i investimeve strategjike në përputhje me misionin, vizionin dhe qëllimet afatgjata të agjencisë.
- Mbikëqyrja e portofolit të investimeve strategjike të propozuara, duke përfshirë alokimin e aseteve, përzgjedhjen e investimeve dhe menaxhimin e rrezikut.

- Identifikimi dhe vlerësimi i mundësive të mundshme investimi, duke përfshirë kapitalin privat, kapitalin sipërmarrës, pasuritë e paluajtshme dhe klasa të tjera të aseteve.
- Kryerja e kujdesit të duhur, analizave financiare dhe vlerësimeve të rrezikut për të vlerësuar qëndrueshmërinë dhe kthimet e mundshme të mundësive të investimit.
- Negocimi i kushteve, çmimeve dhe strukturave të marrëveshjeve me partnerët e investimeve, sipërmarrësit dhe palët e tjera të interesuara.
- Bashkëpunimi me ekipet ligjore dhe financiare për të siguruar që marrëveshjet e investimeve janë të strukturuar në mënyrë të përshtatshme dhe në përputhje me objektivat strategjike të vendit.
- Komunikimi i strategjive afatmesme dhe afatgjata të investimeve, vendimeve dhe përditësimeve të performancës me drejtuesit e lartë, anëtarët e bordit, investitorët dhe palët e tjera të interesuara.

Drejtoria e Investimeve të Huaja Direkte, Partneritetit & Kërkimit

Qëllimi kryesor i Drejtorisë të Investimeve të Huaja Direkte, Partneritetit dhe Kërkimit (IHDPK) është të promovojë Shqipërisë si destinacion investimesh me qëllim tërheqjen e investitorëve të huaj. Ndër të tjera inkurajon investimet nga subjektet e huaja në ekonominë e vendit, duke synuar rritjen ekonomike, krijimin e mundësive për punësim, transferimin e teknologjisë dhe aftësive, të stimulojë inovacionin dhe të përmirësojë infrastrukturën brenda vendit. Njëkohësisht, të mund të ndihmojë në diversifikimin e bazës industriale të vendit drejt konkurrencës së përgjithshme në tregun global. Gjithashtu kjo drejtori ka në mision të saj edhe përkujdesjen ndaj investitorëve të huaj ekzistues në RSH, stimulimin e tyre në riinvestime dhe zgjerim të aktivitetit të tyre edhe në projekte të tjera përveç ekzistuesit.

Funksionet kryesore:

- Ndërtimi dhe mbajtja e marrëdhënieve me investitorët e huaj, zyrtarët e qeverisë dhe palët e tjera të interesuara.
- Ofrimi i ndihmës dhe mbështetjes për investitorët e huaj gjatë gjithë procesit të investimit, duke përfshirë zhvillimin/zgjerimin e kërkesave rregullatore dhe sigurimin e lejeve të nevojshme.
- Negocimi i marrëveshjeve të investimeve, stimujve dhe kushteve të tjera me investitorët e huaj për të maksimizuar përfitimet për vendin.
- Monitorimi dhe vlerësimi i flukseve hyrëse të IHD-ve dhe ndikimi i tyre në ekonominë.
- Bashkëpunimi me departamente ose agjenci të tjera për të promovuar politika dhe rregullore miqësore lidhur me investimet.
- Përfaqësimi i organizatës ose qeverisë në forume dhe negociata ndërkombëtare në lidhje me IHD.

Drejtoria e Investimeve të Huaja Direkte, Partneritetit & Kërkimit

Qëllimi kryesor i Drejtorisë të Zhvillimit të Projektit dhe NVM-ve (Ndërmarrjet e Vogla dhe të Mesme) dhe Eksportit është të identifikojë

dhe zhvillojë projekte që mbështesin rritjen e NVM-ve, zgjerimin e eksportit dhe iniciativat e zhvillimit ekonomik. Kjo mund të përfshijë projekte infrastrukturore, grupime industrie, inkubatorë biznesi dhe iniciativa të tjera që synojnë krijimin e një mjedisi të favorshëm për NVM-të dhe eksportuesit brenda juridiksionit të agjencisë.

Funksionet kryesore:

- Zhvillimi dhe zbatimi i planeve dhe objektivave strategjike për zhvillimin e NVM-ve dhe promovimin e eksportit, në përputhje me misionin, vizionin dhe qëllimet e agjencisë.
- Formulimin e politikave, rregulloreve dhe stimujve për të mbështetur rritjen e NVM-ve dhe për të rritur konkurrencën e eksportit.
- Mbështetjen e reformave të politikave për të krijuar një mjedis të favorshëm biznesi për NVM-të dhe eksportuesit.
- Hartimin dhe zbatimin e programeve dhe projekteve për të mbështetur NVM-të në faza të ndryshme të zhvillimit, duke përfshirë aksesin në financa, ngritjen e kapaciteteve, aksesin në treg dhe adoptimin e teknologjisë.
- Zhvillimin e strategjive dhe iniciativave për promovimin e eksporteve, duke përfshirë kërkimin e tregut, misionet tregtare, pjesëmarrjen në panairë dhe ekspozita tregtare dhe ngritjen e qendrave të asistencës për eksportet.
- Identifikimi dhe synimi i tregjeve të eksportit me potencial të lartë rritjeje për produktet dhe shërbimet e NVM-ve. Sigurimi i inteligjencës së tregut, ndihmës për hyrjen në treg dhe vlerësimet e gatishmërisë për eksport për NVM-të.

Drejtoria Marketing

Qëllimi kryesor i Drejtorisë së Marketingut është mbështetja dhe promovimi në mënyrë efektive i shërbimeve të Agjencisë, mundësitë e investimit dhe propozimin e vlerës për audiencën e synuar. Synimi është tërheqja e investitorëve duke nxjerrë në pah ekspertizën e agjencisë, të kaluarën dhe përfitimet e investimit në projekte ose mundësitë e ofruara nga agjencia, krijimin e materialeve të marketingut, të tilla si broshura investimi, prezantime dhe video për të komunikuar vecoritë unike për mundësi të reja investimi në Shqipëri.

Funksionet kryesore:

- Zhvillon planin dhe strategjinë gjithëpërfshirëse të marketingut në përputhje me qëllimet dhe objektivat e agjencisë.
- Menaxhon identitetin, imazhin dhe reputacionin e agjencisë, si dhe promovon Shqipërinë dhe rajonin në komunitetin e investitorëve mbi mundësitë për investim pranë investitorëve potenciale apo ekzistues.
- Zhvillon fushata dhe programe të marketingut për të promovuar produktet dhe shërbimet e agjencisë.
- Është pikë kontakti për komunikimin ndërkombëtar, ndërinstytucional dhe trupet diplomatike;
- Sigurohet për përditësimin e faqes zyrtare të internetit të Agjencisë;
- Sigurohet për cilësinë e materialeve promovuese (të printuara dhe elektronike), si dhe për plotësimin e kërkesave të legjislacionit në fuqi në fushën e botimeve;
- Koordinon dhe siguron që materialet e marketingut të jenë të përditësuar dhe kujdeset për botimin apo vendosjen e tyre në faqen zyrtare të internetit të Agjencisë;
- Koordinon punën lidhur me përgatitjet për misionet që vijnë, pikat e kontaktit për të dërguar të dhëna periodike dhe materialet për ministrinë, ambasadave dhe stakeholders, si dhe u jep përgjigje ministrive për të dhëna që kërkohen nga Agjencia;

Drejtoria e Financës, Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse

Qëllimi kryesor i Drejtorisë të Financës, Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse është mbështetja e veprimtarisë së Agjencisë, duke zbatuar legjislacionin në fuqi, me qëllim krijimin e infrastrukturës dhe burimet e domosdoshme që garantojnë zhvillimin normal të proceseve të punës, si dhe të ndjekë të gjithë aktivitetin ekonomik – financiar dhe administrativ të Agjencisë, sipas akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi.

Funksionet kryesore:

- Mbështet veprimtarinë e Agjencisë në përputhje me legjislacionin në fuqi, ligjeve të BE, marrëveshjeve ndërkombëtare, duke siguruar gatishmëri dhe garanci materiale e logjistike dhe drejtuar shërbimet e stafit ndihmës dhe teknik;
- Harton, përditëson dhe ndjek zbatimin e rregulloreve dhe akteve të tjera të brendshme të Agjencisë;
- Përgjigjet për menaxhimin e burimeve njerëzore dhe respektimin e përcaktimeve ligjore dhe nënligjore për kushtet, procedurat, të drejtat dhe detyrimet e pranimit, fillimit, vazhimit dhe mbarimit të marrëdhënieve të punës së punonjësve në Agjenci;
- Siguron zbatimin e disiplinës dhe rregullave të etikës nga punonjësit;
- Përgjigjet për përgatitjen e projektbuxhetit për nevojat e Agjencisë dhe ndjek zbatimin e tij;
- Përgjigjet për ndjekjen e procesit të deklarimit të pasurive dhe këshillimin e punonjësit të institucionit në fushën e konfliktit të interesit;



AIDA NË USHTRIM TË FUNKSIONEVE TË VETA

Hyrje

AIDA, ju ndihmon të investoni në Shqipëri duke ju mbështetur me:

Informacione mbi mundësitë e investimit në Shqipëri dhe arsyet kryesore përse vendi ynë është tërheqës për Investimet e Huaja Direkte. Të gjithë informacionin rreth ekonomisë së Shqipërisë, burimet njerëzore, infrastrukturës, stimujve investues prezantohen në një shkallë të gjerë me dokumente në shqip dhe anglisht.

Kontakte nga Shqipëria apo jashtë saj, falë një pune paraprake anketimi dhe misioneve specifike të kontaktit për të përmbushur nevojat e investitorëve. Qasja jonë është të paraqesim ofertën më të kënaqshme shqiptare për kompanitë që kërkojnë ndërkombëtarizim.

Këshilla për mjedisin e përshtatshëm për suksesin e projekteve, rajoneve të funksionimit, planeve të investimeve dhe metodave të financimit.

Ndihmë për investitorët me vizitat eksploruese në Shqipëri dhe në fazat e ndryshme të zbatimit të projektit. Programet e kontaktit me institucionet dhe kompanitë shqiptare në fushat e aktiviteteve të dëshiruara dhe interesave të investitorëve, të cilat përgatiten nga stafi i AIDA-s.

Mbështetje për të përmirësuar qëndrueshmërinë e kompanisë përmes monitorimit të personalizuar dhe ndihmës së vazhdueshme me departamentet e ndryshme ministrore shqiptare, si dhe me organizatat dhe autoritetet rajonale

Investimet e huaja direkte në Shqipëri (IHD)

FLUKSI 2024

Referuar të dhënave nga Banka e Shqipërisë, trendi i investimeve të huaja direkte (IHD) në terma të fluksit, vijon si më poshtë:

| VITI | 2018 | 2019 | 2020 | 2021 | 2022 | 2023 | 2024 |
|--------------------------|-------|-------|------|-------|-------|-------|-------|
| FLUKSI (mln EURO) | 1,020 | 1,073 | 937 | 1,033 | 1,372 | 1,499 | 1,583 |

Burimi: Banka e Shqipërisë, përpunuar nga autori

Për vitin 2024, indikator i **fluksit** shënon vlerën rreth **€ 1.6 miliardë**, duke shënuar shifër rekord në fluksin e investimeve të huaja direkte në vend. Krahasuar me vitin 2023, treguesi i fluksit ka pësuar **një rritje me € 84 milionë** ose me **5.6%**.

FLUKSI SIPAS SHTETEVE^[1]

Për vitin 2024, fluksi i investimeve të huaja në vend është dominuar nga **Turqia** e cila ka kontribuar me rreth **16.2%** në fluksin total, e ndjekur nga **Italia** me **12.6%**, **Hollanda** me **11.1%**, **Austria** me **7.5%** dhe **Kosova** me **6%**.

Më poshtë gjendet tabela me vlerat përkatëse të fluksit për 2024 sipas shteteve kryesore:

Burimi: Banka e Shqipërisë, përpunuar nga autori

| SHTETI | VLERA E FLUKSIT 2024 (mln EURO) |
|-----------------------------|---------------------------------|
| <i>Turqi</i> | 257 |
| <i>Itali</i> | 200 |
| <i>Hollandë</i> | 176 |
| <i>Austri</i> | 119 |
| <i>Kosovë</i> | 96 |
| <i>Gjermani</i> | 84 |
| <i>Francë</i> | 66 |
| <i>SHBA</i> | 61 |
| <i>Zvicër</i> | 35 |
| <i>Bullgari</i> | 28 |
| <i>Mbretëria e Bashkuar</i> | 28 |

[1] 334 milionë Euro i përkasin 'Të tjera për arsye konfidencialiteti'.

FLUKSI SIPAS AKTIVITETIT EKONOMIK

Për vitin 2024, burimi kryesor i hyrjeve të IHD-ve në terma të fluksit ishte sektori i Aktiviteteve të pasurive të paluajtshme që përfaqësonte rreth 24% të fluksit total.

Sektorë të tjerë ekonomik me një kontribut të lartë janë sektori i Aktivitete financiare dhe të sigurimit me 18.1%, i Industrisë nxjerrëse me 13.5%, i Industrisë përpunuese me 11% dhe i Energjisë elektrike, gazit, dhe furnizimit me ujë me 10.4% dhe ai ndaj totalit.

Më poshtë gjendet tabela me vlerat përkatëse të fluksit për 2024 sipas aktiviteteve ekonomike kryesore:

| AKTIVITETI EKONOMIK | VLERA E FLUKSIT 2024 (mln EURO) |
|--|---------------------------------|
| Aktivite të pasurive të paluajtshme | 379 |
| Aktivite financiare dhe të sigurimit | 287 |
| Industria nxjerrëse | 214 |
| Industria përpunuese | 173 |
| Energjia elektrike, gazi, dhe furnizimi me ujë | 166 |

Burimi: Banka e Shqipërisë, përpunuar nga autori


STOKU 2024

Referuar të dhënave nga Banka e Shqipërisë, trendi i investimeve të huaja direkte (IHD) në terma të stokut, vijon si më poshtë:

| VITI | 2018 | 2019 | 2020 | 2021 | 2022 | 2023 | 2024 |
|------------------|-------|-------|-------|-------|--------|--------|--------|
| STOKU (mln EURO) | 7,455 | 7,974 | 8,482 | 9,283 | 11,064 | 13,261 | 15,412 |

Burimi: Banka e Shqipërisë, përpunuar nga autori

Në fund të vitit 2024, indikator i **stokut** shënon vlerën rreth **€ 15.4 miliardë**, duke shënuar shifër rekord në stokun e investimeve të huaja direkte në vend. Krahasuar me vitin 2023, treguesi i stokut ka pësuar **një rritje me rreth € 2.2 miliardë** ose **16.2 %**.



Burimi: Banka e Shqipërisë, përpunuar nga autori

STOKU SIPAS SHTETEVE

| SHTETI | VLERA E STOKUT 2024 (mln EURO) |
|-----------------|--------------------------------|
| <i>Hollandë</i> | 2,544 |
| <i>Zvicër</i> | 2,267 |
| <i>Kanada</i> | 1,921 |
| <i>Itali</i> | 1,683 |
| <i>Turqi</i> | 1,299 |
| <i>Austri</i> | 875 |
| <i>Bullgari</i> | 874 |
| <i>Francë</i> | 584 |
| <i>Gjermani</i> | 490 |
| <i>Kosovë</i> | 422 |

Burimi: Banka e Shqipërisë, përpunuar nga autori

STOKU SIPAS AKTIVITETIT EKONOMIK

Në fund të vitit 2024, burimi kryesor i hyrjeve të stokut të IHD-ve ishte **Energjia elektrike, gazi, dhe furnizimi me ujë** që përfaqësonte **23.7%** të stokut total. Sektorë të tjerë ekonomik me një kontribut të lartë në IHD në terma të stokut janë sektori i **Industrisë nxjerrëse** me **16.4%**, **Aktiviteve të pasurive të paluajtshme** me **13.2%**, i **Aktiviteve financiare dhe të sigurimit** me **11.6%**, i **Informacionit dhe Komunikacionit** me **9.8%** dhe i **Industrisë përpunuese** me **9.2%** ndaj totalit.

Më poshtë gjendet tabela me vlerat përkatëse të stokut për vitin 2024 sipas aktiviteve ekonomike kryesore:

| AKTIVITETI EKONOMIK | VLERA E STOKUT 2024 (mln EURO) |
|--|--------------------------------|
| Energjia elektrike, gazi, avulli dhe furnizimi me ajër të kondicionuar | 3,659 |
| Industria nxjerrëse | 2,534 |
| Aktivite të pasurive të paluajtshme | 2,038 |
| Aktivite financiare dhe të sigurimit | 1,797 |
| Informacioni dhe komunikacioni | 1,516 |
| Industria përpunuese | 1,422 |

Burimi: Banka e Shqipërisë, përpunuar nga autori

LEAD GENERATION DHE AFTERCARE

Gjenerimi i Leads

AIDA vazhdon të luajë një rol kyç në mbështetjen dhe orientimin e investitorëve të huaj dhe vendas, duke ofruar asistencë të vazhdueshme për kompanitë e interesuara që synojnë të investojnë në Shqipëri. Nëpërmjet një qasjeje proaktive, AIDA u mundëson investitorëve informacion të përditësuar dhe të detajuar mbi klimën e biznesit në vend, sistemin fiskal dhe doganor, kuadrin ligjor për investimet, lehtësirat dhe incentivat fiskale që ofrohen për investitorët e huaj, si dhe mundësitë për krijimin e partneriteteve me biznese vendase në sektorë të ndryshëm të ekonomisë.

Gjatë vitit 2024, AIDA ka ndjekur dhe asistuar nga afër gjashtë kompani ndërkombëtare të rëndësishme, të cilat kanë shprehur interes për të investuar në Shqipëri: Lidl, Zuegg, Perutnina Ptuj, Tratos, Insit Group dhe Roncadin. Gjithashtu, është riaktivizuar interesi i kompanisë Visccher-Caravelle, e cila më parë kishte shfaqur interes për tregun shqiptar.

Për të gjitha këto kompani, AIDA ka ofruar shërbime të personalizuar dhe asistencë të drejtpërdrejtë, përfshirë:

- Akses në informacione të detajuara mbi tregun shqiptar dhe sektorët potencialë për investim;
- Përmirësimin e komunikimit ndërinstitucional me organet përkatëse qeveritare, për të lehtësuar proceset administrative dhe koordinimin institucional;
- Identifikimin aktiv të opsioneve të përshtatshme të pronave që përmbushin kërkesat e kompanive të interesuara;



Strategjia e Zhvillimit të Biznesit dhe Investimeve 2021 - 2027

Strategjia e Zhvillimit të Biznesit dhe Investimeve 2021- 2027 (BIDS), është një dokument ligjor me rëndësi të veçantë për zhvillimin e biznesit dhe investimeve, duke e konsideruar adresimin e duhur të tyre si kusht drejt një zhvillimi të qëndrueshëm. Kjo strategji përbën orientimin kryesor të Qeverisë Shqiptare për zhvillimin ekonomik afat-mesëm, duke u fokusuar kryesisht në zhvillimin e ndërmarrjeve mikro, të vogla dhe të mesme si edhe investimet. AIDA është një aktor i rëndësishëm në implementimin në praktikë të BIDS dhe praktikave të parashikuara nga strategjia.

Në zbatim të pikës 2 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.466, datë 30.7.2021 “Për miratimin e Strategjisë së Zhvillimit të Biznesit dhe Investimeve, 2021-2027, dhe planit të veprimit të saj”, është krijuar ngritja e një grupi pune ndërinstytucional për monitorimin e strategjisë nën drejtimin e MEKI-t. Bazuar në Urdhrin e KM nr. 214, datë 13.12.2023 “Për ngritjen e grupit të punës ndërinstytucional për monitorimin e Strategjisë së Zhvillimit të Biznesit dhe Investimeve 2021-2027 dhe planit të veprimit të saj”, grupi i punës kishte këto detyra:

- Monitorimi dhe raportimi për ecurinë e zbatimit të aktiviteteve dhe masave të planit të veprimit të BIDS 2021-2027 në përputhje me udhëzuesin metodologjik për hartimin e raporteve të monitorimit për Axihendën e Qeverisjes së Mirë;
- Raportimi i ecurisë së treguesve dhe objektivave të portofolit të performancës së strategjisë.

Siç konfirmohet nga raporti i monitorimit, tashmë është bërë progres i konsiderueshëm në zbatimin e BIDS 2021-2027. Nga 36 aktivitetet e parashikuara në planin e veprimit,

- Janë zbatuar 21;
- 5 janë ende në proces zbatimi;
- 10 nuk janë zbatuar ende.

Zhvillimi i fushatave promovuese për tërheqjen e investimeve

Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve (AIDA), me mbështetjen e Regional Cooperation Council (RCC) dhe World Bank Group (WBG) zhvilloi një fushatë outreach me fokus sektorin e turizmit në Spanjë përgjatë datave 18-20 Qershor 2024.

Në kuadër të tërheqjes së brandeve elitare europiane në tregun vendas, AIDA zhvilloi takime fizike me disa prej grupeve hoteliere më në zë spanjolle, duke përfshirë Barcelo Group, Catalonia Hotels dhe Eurostar Hotels by Groupo Hotusa për të prezantuar ofertën e qeverisë shqiptare, incencivat fiskale të sektorit të turizmit, avantazhet konkurruese të Shqipërisë etj.

Gjatë takimeve u konstatua një interes i lartë për t'u bërë pjesë e tregut shqiptar dhe se vemendja e grupeve hoteliere më të mëdha spanjolle është të zhvillojnë struktura elitare në bregdetin shqiptar, por pa përjashtuar dhe vendosjen në qytetet më të mëdha në vend që ofrojnë turizëm 12-mujor si Tirana, Durrësi, Vlora etj.

Në përfundim të këtyre takimeve, AIDA zhvilloi gjithashtu një takim me Ambasadën e Republikës së Shqipërisë në Madrid dhe me Dhomën e Ekonomisë Shqipëri - Spanjë ku krahas diskutimeve mbi interesin e shtuar drejt Shqipërisë si një destinacion për të investuar në sektorin e turizmit dhe jo vetëm, u vlerësua dhe nevoja për një koordinim të shtuar dhe sa më eficient të aktorëve publik dhe privatë në funksion të realizimit të objektivit të përbashkët të fuqizimit të ekonomisë shqiptare.

Në muajin tetor 2024, përfaqësuesi i Eurostar Hotels vizitoi Shqipërinë si edhe realizoi një takim pranë zyrave të AIDA.

Misioni i Parë i Biznesit Shqipëri - Poloni

Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve (AIDA), në përmbushje të funksionit të saj si institucioni kyç për tërheqjen e investimeve të huaja në Shqipëri dhe forcimin e potencialit eksportues të vendit, në bashkëpunim të ngushtë me Ambasadën Shqiptare në Poloni dhe PAIH (Polish Trade and Investment Agency), organizoi për herë të parë një mision tregtar në Varshavë, gjatë datave 18 - 19 nëntor 2024. Misioni synonte identifikimin e partnerëve të rinj dhe tregjeve potenciale për kompanitë shqiptare, duke ofruar mundësi konkrete për zhvillim dhe zgjerim ekonomik. Ai u organizua me një fokus të veçantë në sektorët e bimëve medicinale dhe prodhimit të produkteve të kujdesit të lëkurës.

PAIH priti delegacionin shqiptar duke prezantuar agjencinë dhe rolin e saj në mbështetje të biznesit. Përfaqësuesi i AIDA mbajti një prezantim të detajuar mbi mundësitë e investimeve në Shqipëri, potencialin që vendi ofron dhe incentivat tërheqëse për investitorët e huaj. Në këtë kuadër, u zhvilluan një seri takimesh B2B mes kompanive shqiptare dhe polake, duke krijuar ura të reja bashkëpunimi ekonomik. Këto takime shërbyen si platforma ideale për krijimin e kontakteve të qëndrueshme dhe për hapjen e mundësive për rritje të tregtisë mes dy vendeve.

Delegacioni shqiptar u prit nga Ambasadorja e Shqipërisë në Poloni, Shkëlqesia e Saj, znj. Mimoza Halimi, në ambientet e Ambasadës Shqiptare në Varshavë. Ajo theksoi rëndësinë strategjike të këtij misioni për forcimin e marrëdhënieve dypalëshe, duke inkurajuar vazhdimin e bashkëpunimeve të tilla për të zgjeruar horizontet ekonomike mes dy vendeve.

Delegacioni shqiptar vizitoi gjithashtu Ptak Warsaw Expo, për t'u njohur nga afër me mundësitë për pjesëmarrje në panairët ndërkombëtare. Një tjetër moment kyç ishte vizita në Bionanopark, një park shkencor dhe teknologjik që paraqet standardet më të larta në zhvillimin inovativ, si dhe takimet me përfaqësuesit e Łódź Special Economic Zone, një zonë me potencial të jashtëzakonshëm për investitorët e huaj.

Pjesë e agjendës ishte edhe një takim me Dr. Paweł Michalak, Konsull i Nderit i Shqipërisë në Poloni, i cili shprehu angazhimin e tij për të mbështetur intensifikimin e lidhjeve ekonomike dypalëshe.

Ky mision dëshmoi potencialin e jashtëzakonshëm për zhvillimin e lidhjeve tregtare dhe investimeve dypalëshe mes Shqipërisë dhe Polonisë, duke hapur horizonte të reja për bashkëpunim ekonomik në sektorë të ndryshëm.

AFTERCARE

Gjatë vitit 2024, Sektori Lead & Aftercare pranë Drejtorisë së Investimeve të Huaja, Partneritetit dhe Kërkimit në AIDA organizoi 2 fushata të shërbimit të përkujdesjes ndaj investitorit, 2 tryeza të rrumbullakëta me kompani të sektorit automotiv dhe turizmit si dhe ndërmori nismën "Investor Support Days". Rrjeti i bashkëpunimit me qeverisjen lokale funksionon aktualisht me 12 bashki të vendit, përkatësisht Shkodër, Vlorë, Tiranë, Durrës, Berat, Lezhë, Fier, Elbasan, Kavajë, Vorë, Kamëz dhe në 2024 me bashkinë Korçë.

Në vitin që lamë pas AIDA ka takuar 163 kompani përmes vizitave në terren, tryezave të rrumbullakëta por dhe përmes takimeve të investitorëve të huaj në vendin tonë, si dhe ka asistuar 18 subjekte për problematika të natyrave të ndryshme.

Plani i Veprimit Aftercare për vitin 2024

Tryezat e rrumbullakta në sektorin automotiv dhe turizëm

Në muajin Prill u zhvillua Tryeza e Rrumbullakët e Sektorit Automotiv me 6 kompanitë më të njohura e sektorit si Delmon Group, Forscher Albania, YURA, SV MEGA, Timak dhe SEËS CABIND Albania. Kjo tryezë u mbajt duke u nisur nga problematikat e shfaqura nga investitorët në fushatat aftercare që AIDA ka zhvilluar dhe sektori automotiv si me potencial për zhvillimin ekonomik të vendit.

Rekomandimet që u dhanë në këtë tryezë nga kompanitë e pranishme u deleguan pranë institucioneve përgjegjëse për zgjidhje duke patur në vëmendje përmirësimin e klimës së biznesit në vend.

AIDA më pas vijoi me fushatën e dedikuar në sektorin e turizmit me subjektet më në zë të turizmit si Marriott, Plaza Tirana, Elisa by Melia, Mercure Hotel etj. Kjo fushatë u fokusua kryesisht te brandet hoteliere që operonin në zonën e kryeqytetit, duke patur si referencë një pyetësor i cili synonte të identifikonte nevojat dhe boshllëqet e sektorit para nisjes së sezonit turistik 2024. Në bazë të treguesve dhe boom-it që pati sektori turistik i verës 2024 u zhvillua dhe Tryeza e Rrumbullakët e Sektorit të Turizmit me 15 kompani lider në turizëm si Plaza Tirana, Marina Bay Vlorë, Movenpick Lalëz, Melia, Rogner etj. Të pranishëm ishin znj. Laura Saro, Drejtoreshë Ekzekutive e AIDA-s, znj. Ilva Gjuzi, Zëvendësministre e Turizmit dhe Mjedisit, z. Ermal Dredha, Kryetar i Bashkisë Vlorë, znj. Elira Kokona, Drejtoreshë Ekzekutive e Korporatës Shqiptare të Investimeve, znj. Anuela Ristani, Zëvendës Kryetare e Bashkisë Tiranë, përfaqësues nga AKPA dhe përfaqësues nga Bashkia Shkodër dhe subjekte private që operojnë në fushën e turizmit. Diskutimet u përqendruan në mundësitë dhe sfidat me të cilat përballlet sektori, duke theksuar rëndësinë e bashkëpunimit midis institucioneve dhe biznesit për të promovuar turizmin në Shqipëri.

Iniciativa “Investors support day”

Gjatë muajve tetor-nëntor 2024 me bashkëpunimin e Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit AIDA inicioi nismën "Investors Support Days". Kjo iniciativë u zhvillua përmes takimeve javore me kompanitë gjermane, italiane, turke, greke, franceze, austriake dhe hungareze. AIDA pati përfaqësinë e institucioneve si Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, Ministria e Shtetit për Pushtetin Vendor, Ministria e Financave, AKPA, AKBN, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave dhe Korporata e Investimeve Shqiptare.

Pjesë ishin gjithashtu ambasadat e Gjermanisë, Italisë, Turqisë, Greqisë, Francës, Austrisë dhe Hungarisë si dhe DIHA-s, Dhomës Italiane të Tregtisë, Confindustria, MUSIAD, Shoqata Greke e Biznesit në Shqipëri si dhe Advantage Austria.

Në tryezën hapëse “German Investors Support Day” morën pjesë Ministri i Shtetit për Pushtetin Vendor z. Arbjan Mazniku, Zëvendës Ambasadori i Gjermanisë, z. Thilo Schroeter, dhe Drejtori i AKPA z. Klevis Hysa. Kompanitë e pranishme ishin Lindner Group (Tirana Business Park + MK Hotels), PSZ GmbH Albania, DHL, Röfix, Forscher, GOPA Worldwide Consultants, Sun Herb, Acromax, Dekra Akademie dhe Vega Solar. Shumë prej këtyre çështjeve të raportuara lidheshin me kompetencat dhe fushëveprimin e njësive të qeverisjes vendore si dhe me politikën fiskale.

Tryeza vijuese ishte “Italian Investor Support Day” e cila pati praninë e Ministrisë të Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, z. Blendi Gonxhja, Zëvendës Ministrit të MEKI, z. Sokol Duma, Zëvendës Ministren e Financave, znj. Vasilika Vjero, Drejtorin e AKPA, z. Klevis Hysa dhe Zëvendës Ambasadorin e Italisë, z. Stefano Salmaso ku u theksua rëndësia e vazhdimin të mbështetjes për investimet italiane në Shqipëri. Në këtë tryezë morën pjesë rreth 30 kompani nga sektorë të ndryshëm. Në fokus të këtij takimi ishte bashkëbisedimi me investitorët, ku ata patën mundësinë të sugjeronin dhe adresonin çështjet e rëndësishme për ta në kuadër të përmirësimit të klimës së investimeve. Ministri z. Blendi Gonxhja, siguroi për investitorët përpjekjet maksimale nga MEKI për të forcuar bashkëpunimin ekonomik mes dy vendeve.

Në vazhdim të kësaj nisme u organizua “Turkish Investors Support Day” me bashkëpunimin e Musiad Albania dhe kreut z. Muhammet Isler, dhe me pjesëmarrjen e Znj. Elira Kokona nga Korporata e Investimeve Shqiptare, Drejtorit Ekzekutiv të AKBN Z. Erlind Sulo si dhe Znj. Arjana Dyrmishi, Drejtoreshë e Programit, Statistikës dhe Analizës së të Ardhurave në Ministrinë e Financave. Në takim mori pjesë dhe Znj. Pelin Ozdemir, Këshilltare e çështjeve të tregtisë pranë Ambasadës së Turqisë në Shqipëri. Kompanitë pjesëmarrëse ishin Albchrome, BKT, Ayen Energji, Global Distribution, Tete Mining, Loca Albania, Hegi Logistics, DSD Group etj.

Kjo tryezë, ashtu si dhe ato paraardhëse u fokusua te diskutimi i aktivitetit të kompanive turke në Shqipëri, problematikat që hasin gjatë implementimit të planit të tyre të biznesit dhe mbi të gjitha në shqyrtimin e mundësive për bashkëpunim me institucionet në vendin tonë, duke dhënë dhe sugjerimet përkatëse.

Më pas kjo nismë vijoi me “Austrian Investors Support Day”, në bashkëpunim me ambasadën e Austrisë në vendin tonë, Advantage Austria dhe me praninë e Zv/Ministres së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit znj. Blerta Rama, ambasadores së Austrisë në Shqipëri znj. Monica Zach dhe përfaqësues nga DPT (Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve). Zëvendësministrja Znj. Rama i garantoj investitorët austriakë për përpjekjet maksimale të MEKI për të përmirësuar klimën e biznesit në Shqipëri dhe se çdo problematikë që ata kanë do adresohet dhe do zgjidhet në kuadër të përmirësimit të vazhdueshëm.

Takimet përmblyëse në vijim të Investor Support Day ishin “French Investors Support Day” me kompanitë franceze dhe “Hungarian Investors Support Day” me kompanitë hungareze, me pjesëmarrjen e përfaqësuesve të ambasadave përkatëse, Zv/Ministres Znj. Blerta Rama dhe me përfaqësues të AKPA.

Në këtë nismë morën pjesë një total prej 120 kompanish. Ne vijim të problematikave të raportuara u deleguan dhe u ndoqën me prioritet shkresat dhe korrespondenca elektronike me institucionet e qeverisjes qendrore për 10 kompani.

IDENTIFIKIMI I PRONAVE ME POTENCIAL PËR INVESTIME

Gjatë vitit 2024, Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve (AIDA) ka vijuar angazhimin për identifikimin dhe propozimin e pronave potenciale për zhvillim investimesh, në bashkëpunim të ngushtë me Ministrinë e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, si dhe me ministritë e linjës. Ky proces është pjesë e përpjekjeve të vazhdueshme për të përmbushur kërkesat e investitorëve dhe për të krijuar një mjedis sa më tërheqës për zhvillimin e projekteve strategjike në sektorë kyç të ekonomisë.

Në kuadër të këtij angazhimi, AIDA ka bashkëpunuar posaçërisht me Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural (MBZHR), me qëllim identifikimin e pronave të përshtatshme për investime në sektorin bujqësor. MBZHR ka ofruar asistencë teknike dhe rekomandime mbi kriteret që duhet të përmbushin këto prona, duke mundësuar shqyrtimin e disa alternativave me potencial të lartë për investime afatgjata dhe me kushte të favorshme për zhvillim ekonomik në zonat rurale.

Pronat e identifikuara më parë, vijojnë të jenë potenciale për shfrytëzim nga investitorët vendas dhe të huaj, prona si :

- Ish Kombinati Metalurgjik, Elbasan
- Aseti Uzina e Plehrave Azotike, Fier
- Aseti Fabrika e Duhan Cigareve, Shkodër
- Uzina e telave dhe e kabllove, Shkodër
- Ish Vaskat e Peshkut, Korçë

INICIATIVA TË DREJTORISË SË INVESTIMEVE PËRGJATË 2024

Memorandume Bashkëpunimi

Memorandum Bashkëpunimi me Bashkinë Korçë

Në muajin shkurt, stafi i AIDA-s realizoi një vizitë në Bashkinë Korçë për të shtrirë rrjetin e bashkëpunimit me bashkitë e vendit, duke u fokusuar në ofrimin e shërbimeve Aftercare për investitorët ekzistues në Shqipëri. Gjatë kësaj vizite, AIDA nënshkroi një marrëveshje bashkëpunimi me Bashkinë Korçë, e cila ka për qëllim krijimin e kushteve për ri-investime dhe shkëmbimin e të dhënave dhe informacionit lidhur me investimet e huaja direkte. Pjesë e këtij bashkëpunimi është dhe ofrimi i një databaze me kontakte të bizneseve të huaja që operojnë në Korçë, duke mundësuar një ndihmë të mëtejshme për bizneset që hasin problematika të ndryshme.

Ky bashkëpunim thellon angazhimin e AIDA-s në mbështetje të zhvillimit të investimeve dhe në ofrimin e shërbimeve të dedikuara për investitorët, duke përmirësuar gjithashtu marrëdhëniet ndërinstitucionale dhe duke promovuar zhvillimin ekonomik të rajoneve.

Memorandum Bashkëpunimi me ATTSO

Në muajin qershor, AIDA organizoi forumin “Global Energy Insights: Albania Investments & Market Trends” në bashkëpunim me Dhomën Shqiptaro-Turke të Tregtisë dhe Industrisë (ATTSO). Ky forum përfshiu përshëndetje nga Drejtorja Ekzekutive e AIDA-s, znj. Laura Saro, dhe Kryetari i Bordit të ATTSO, z. Bilal Kara. Znj. Saro mbajti një prezantim mbi mundësitë e investimeve në Shqipëri dhe rolin e AIDA-s në përmirësimin e klimës së biznesit dhe lehtësirave për investitorët e huaj. Pas këtij prezantimi, paneli u pasua nga fjalime të rëndësishëm nga përfaqësues të institucioneve të ndryshme, si z. Besjan Kadiu, Drejtor i Politikave dhe Strategjive të Zhvillimit të Industrisë dhe Energjisë në MIE, dhe përfaqësues të ERE, UPT dhe BKT.

Ky forum i shërbeu forcimit të marrëdhënieve dhe bashkëpunimit ndërkombëtar, ndërsa AIDA nënshkroi një Memorandum Bashkëpunimi me ATTSO, një hap më tej për fuqizimin e raporteve ekonomike dypalëshe.

Memorandum Bashkëpunimi me Agjencinë Malazeze të Investimeve

Në zyrën e AIDA-s, u zhvillua një takim me Znj. Snežana Đurović, drejtoreshë e Agjencisë Malazeze të Investimeve, për të nënshkruar një Memorandum Mirëkuptimi midis dy agjencive homologe. Takimi përqendrohej në forcimin e bashkëpunimit dhe avancimin e projekteve të investimeve në sektorë të ndryshëm, duke përfshirë TEDA-n, sektorin e turizmit dhe investimet strategjike.

Të dyja palët u angazhuan për një bashkëpunim më të ngushtë në promovimin e investimeve, shkëmbimin e informacionit dhe praktikat më të mira në fushën e investimeve, me fokus në mbështetje për zhvillimin ekonomik dhe përmirësimin e mundësive për investitorët.

Forume Biznesi

AIDA ka organizuar një seri forumesh që kanë ndihmuar në promovimin e mundësive për investime dhe përmirësimin e klimës së biznesit në Shqipëri.

Këto forume janë të rëndësishme për sipërmarrësit dhe investitorët e interesuar për të eksploruar mundësitë e tregut shqiptar. Pjesëmarrësit kanë mundësinë të krijojnë lidhje me sipërmarrës dhe profesionistë nga vende të ndryshme, duke hapur mundësi për zhvillimin e projekteve të përbashkëta. Gjatë vitit 2024 AIDA vazhdon të luajë një rol kyç në promovimin e Shqipërisë si destinacion tërheqës për investime dhe në krijimin e mundësive për zhvillim ekonomik dhe bashkëpunim ndërkombëtar.

Forumi i Biznesit Shqipëri – Çeki

Në bashkëpunim me Ambasadën e Republikës Çeke në Shqipëri dhe Ministrinë për Evropën dhe Punët e Jashtme, AIDA organizoi Forumin e Biznesit Shqipëri – Çeki, një ngjarje që pasqyroi vullnetin e përbashkët për të thelluar bashkëpunimin ekonomik dhe për të eksploruar mundësitë e reja dypalëshe. Gjatë forumit, u zhvillua një sesion i takimeve B2B, ku kompanitë shqiptare dhe çeke diskutuan mundësitë e bashkëpunimit dhe krijimin e partneriteteve të mundshme në sektorë të ndryshëm, përfshirë energjinë, turizmin, bujqësinë dhe teknologjinë. Si rezultat i këtij forumi, u arritën partneritete strategjike mes bizneseve të të dyja vendeve.

Forumi i Biznesit Shqipëri – Arabi Saudite

Në muajin Mars 2024, AIDA organizoi forumin e biznesit “Shqipëri – Arabi Saudite”. Në këtë forum, AIDA mbledhi rreth 50 biznese arabe dhe 50 biznese shqiptare, duke krijuar mundësi për lidhje dhe shkëmbime mes dy grupeve të biznesit. Forumi përfshiu takime B2B dhe B2G, ku përfaqësues të qeverisë shqiptare diskutuan mundësi investimi dhe bashkëpunimi me bizneset saudite. Forume të tilla kanë një rol kyç në përmirësimin e mjedisit të biznesit në Shqipëri dhe krijimin e mundësive të reja për rritje dhe zhvillim ekonomik, duke sjellë ndikime pozitive në zhvillimin e qëndrueshëm të biznesit dhe ekonomisë shqiptare.

Forumi i Biznesit Shqipëri – Emiratet e Bashkuara Arabe

Në muajin Nëntor, AIDA organizoi Forumin e Biznesit Shqipëri – Emiratet e Bashkuara Arabe (EBA), i cili përfshiu një delegacion të lartë, të udhëhequr nga Ministri për Tregtinë e Jashtme, Sh.T.Z. Thani Bin Ahmed Al Zeyoudi. Delegacioni përfshinte përfaqësues të kompanive elitare nga sektori i energjisë, teknologjisë dhe ndërtimit. Pjesëmarrësit në forum diskutuan mundësitë e rritjes së investimeve dhe shkëmbimeve tregtare, dhe realizuan takime B2B për të eksploruar mundësi për projekte të reja. Kompanitë si Masdar, JAFZA, ADNOC Global Trading, Kumo Industries dhe Oumolat ishin disa nga përfaqësuesit kryesorë të delegacionit të Emirateve të Bashkuara Arabe.

ANGAZHIMI INSTITUCIONAL DHE RITJJA E KAPACITETEVE

AIDA pjesëmarrëse në Grupin e Përbashkët të Punës për Investime për Rajonin e Ballkanit Perëndimor

Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve mori pjesë në Grupin e Përbashkët të Punës për Investime për Rajonin e Ballkanit Perëndimor, të zhvilluar më 28 Maj 2024. Kjo mbledhje u organizua nga Këshilli Rajonal i Bashkëpunimit (RCC), me pjesëmarrjen e përfaqësuesve të IPA-ve përkatëse dhe ministrive përgjegjëse për ekonominë të 6 vendeve të Ballkanit Perëndimor. Takimi u mbajt në Budva dhe u zhvillua në bashkëpunim me Komisionin Evropian dhe Grupin e Bankës Botërore.

Qëllimet kryesore të mbledhjes ishin avancimi i punës për standardet rajonale të screening të investimeve të huaja direkte, prezantimi dhe diskutimi i gjendjes aktuale të inventarëve të incentivave të investimeve dhe materialeve rajonale promovuese të investimeve, si dhe adresimi i çdo sfide të mundshme që lidhet me fushatat outreach. Gjithashtu, takimi kishte për qëllim shqyrtimin e draft masave për CRM-në e re lidhur me investimet.

AIDA pjesëmarrëse në trajnimin "Investment Facilitation, Decent Work and Sustainable Development"

Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve mori pjesë në trajnimin "Investment facilitation, decent work and sustainable development", në Torino, nga 11 deri më 14 qershor 2024.

Ky trajnim u organizua nga Unioni për Mesdheun (UfM), i mbështetur nga GIZ dhe në partneritet me Qendrën Ndërkombëtare të Trajnimit të Organizatës Ndërkombëtare të Punës (ITCILO) dhe mblodhi së bashku përfaqësues nga Agjencitë për Promovimin e Investimeve (IPA), ministrinë përkatëse dhe organizatat për mbështetjen e biznesit nga i gjithë rajoni.

Gjatë katër ditëve të trajnimit u trajtuan një sërë temash nga ekspertë të ndryshëm si Karl Pfeffer (ITCILO), Axel Berger (Instituti i Zhvillimit dhe Qëndrueshmërisë), Paul Wessendorp (UNCTAD), Lena-Katharina Markart-Bahreini (GIZ), Alexandre de Crombrughe, Ana Laura Sobalbarro Herrera (OECD), Andreas Hora (WAIPA) dhe Brian Portelli (UNDO).

Temat e zhvilluara përfshinin:

- Politikat që lidhen me lehtësimin e investimeve dhe zhvillimin e qëndrueshëm, duke përfshirë Agjendën 2030 për Zhvillim të Qëndrueshëm, sjelljen e përgjegjshme të biznesit dhe zinxhirët e furnizimit të qëndrueshëm.
- Çështje tematike si IHD-të në energjinë e rinovueshme dhe gjenerimi i punësimit të denjë.
- Forcimin institucional të IPA-ve për të përmbushur mandatet e tyre, duke përfshirë zhvillimin e treguesve kyç të performancës (KPI) për të matur ndikimin e IHD-ve në punën e denjë, duke përdorur teknologjinë dhe dixhitalizimin, dhe duke përmirësuar rrjetëzimin rajonal.

Forumi i Biznesit Shqipëri – Emiratet e Bashkuara Arabe

Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve (AIDA) mori pjesë në “ABSL Forum 2024”, i cili u mbajt në Porto, Portugali nga data 7 deri më 8 nëntor 2024.

Ky forum u organizua nga Shoqata e Drejtuesve të Shërbimeve të Biznesit (ABSL - The Association of Business Service Leaders). Qëllimi i ABSL është të ndërtojë një komunitet të bashkuar palësh të interesuara të sektorit të shërbimeve që vazhdimisht promovojnë rritjen e vazhdueshme dhe të qëndrueshme si edhe forcimin e pozitës së këtij sektori.

Eventi “ABSL Forum 2024” ofroi një platformë të shkëlqyer për të diskutuar dhe shkëmbyer mendime rreth mundësive dhe sfidave me të cilat përballen mbi 40 milionë profesionistë të shërbimeve të biznesit në Evropë. Një nga temat kryesore të eventit ishte analiza e tendencave të reja të investimeve dhe ndikimi i faktorëve gjeopolitikë në vendimmarrjet për investime.

AIDA e shfrytëzoi këtë mundësi për të zhvilluar takime të frytshme me AICEP Portugal Global dhe Invest Porto. AICEP, Agjencia Portugeze e Tregtisë dhe Investimeve është institucioni publik që promovon dhe tërheq investimet e huaja, si edhe nxit rritjen e eksporteve dhe zgjerimin ndërkombëtar të kompanive portugeze. Invest Porto është agjencia e promovimit të investimeve, e themeluar nga Këshilli i Qytetit të Portos, e cila mbështet investimet e huaja në Porto. Diskutimet u përqëndruan në forcimin e partneriteteve, ndarjen e praktikave më të mira dhe eksplorimin e mundësive për bashkëpunim midis Shqipërisë dhe Portugalisë.


Përfaqësues të AIDA organizuan gjithashtu një takim me ABSL Albania, gjatë të cilit u dakordësua nënshkrimi i një MoU.

INVESTIMET STRATEGJIKE

Me hyrjen në fuqi të paktës së re ligjore për investimet strategjike (datë 24.12.2015), u bë e mundur që investimet vendase dhe të huaja, në sektorët më të rëndësishëm të shpallur strategjike, të lëvizin më me shpejtësi, me procedura të përshpejtuara dhe favorizuese.

Në zbatim të kësaj pakete ligjore, AIDA ka tre funksione të tjera shtesë:

- One Stop Shop për aplikimet për investim/ investitor strategjik
- Sekretariat Teknik i Komitetit të Investimeve Strategjike (KIS)
- Agjent asistues i investitorit strategjik



Referuar legjislacionit të investimeve strategjike, AIDA në cilësinë e One Stop Shop ka të gjithë autoritetin e nevojshëm për të pranuar dosjet, shqyrtuar, kontrolluar përputhshmërinë e aplikimeve, dhe më pas të koordinojë vendimmarrjen.

Në këtë aspekt, One Stop Shop:

- Kryen veprimet përgatitore dhe shërbimet e nevojshme ndaj projektit potencial strategjik dhe investitorit/investitorëve potencialë strategjikë (pra dy statuse të ndryshme), veçanërisht ato të verifikimit të tokës dhe përputhjes së projektit të investimit me planin kombëtar të rregullimit të territorit (proces i cili përfshin një sërë institucionesh njëkohësisht);
- Koordinon procesin vlerësues të një projekti nga Grupi Operacional, me shpejtësi dhe efikasitet (brenda një afati maksimal prej 30 ditësh);
- Përgatit raportet për KIS, në rolin e Sekretariatit Teknik dhe harton një sërë aktesh administrative pas vendimeve të KIS.

Duke qenë se procedurat kanë krijuar tashmë precedent, edhe mbledhjet e KIS për një projekt janë reduktuar. (Ligji 55/201, i ndryshuar parashikon që KIS ka 30 ditë pune afat për të marrë një vendim lidhur me një projekt investimi që i propozohet nga grupi operacional). Njëkohësisht sipas ligjit, KIS, pasi aprovon statusin strategjik, duhet të miratojë dhe planin e veprimit (masat shtetërore) për projektin në shqyrtim. Për këtë arsye, Grupet Operacionale japin kontributin e tyre, njëkohësisht, edhe për vlerësimin teknik të projektit, edhe për planin e veprimit mbi masat shtetërore që vlerësohen se duhet t'i jepen projektit. Mbi këtë bazë, Sekretariati Teknik paraqitet në KIS me dy materiale njëherazi: (i) raportin e vlerësimit teknik dhe (ii) planin e veprimit. Afati 30 ditor shfrytëzohet për të zbardhur vendimin dhe rekomandime shtesë të KIS.

Projekte te vlerësuar nga Komiteti i Investimeve Strategjike (KIS) përgjatë vitit 2023 dhe 2024

Projekte të shqyrtuara nga AIDA 2023-2024:

| VITI | 2023 | 2024 | TOTALI |
|-------------------------------------|------|------|--------|
| Projekte totale të trajtuara | 16 | 14 | 30 |
| Projekte të miratuara | 6 | 8 | 14 |
| Projekte të refuzuar | 10 | 6 | 16 |
| Shqyrtime të tjera* | 4 | 4 | 8 |

Përgjatë vitit 2024, pranw AIDA kanë aplikuar 14 subjekte nga të cilët 8 prej tyre kanë përfituar statusin strategjik dhe duke përfituar nga masat mbështetëse të parashikuara nga legjislacioni për investimet strategjike dhe 6 prej tyre nuk i është pranuar kërkesa për përfitimin e statusit strategjik. Përveç sa më sipër, përgjatë vitit 2024 AIDA ka asistuar në fazë paraprake edhe 16 projekte, të cilat, për arsye të ndryshme nuk janë pranuar si aplikime ose subjektet aplikues nuk kanë vijuar me aplikimin përfundimtar, duke e çmuar atë për një moment të dytë.

**Shqyrtime të tjera që ka bërë KIS përgjatë vitit 2024 kanë të bëjnë me:*

- praninim për shtyrje afati të statusit strategjik për 3 projekte;
- mospraninim për shtyrje afati të statusit strategjik për 2 projekte;


Projektet sipas sektorëve strategjikë

Projektet e shqyrtuara përgjatë vitit 2023 i përkasin sektorit të turizmit, i cili kanë më të madh të projekteve të investimit (10), duke u ndjekur më pas nga sektori i TEDA (3) dhe (1) projekti që ka përfutur statusin “Projekt me potencial strategjik”. Në krahasim me vitin 2023, në vitin 2024 janë trajtuar:


- 10 projekte në sektorin e turizmit, prej të cilëve janë miratuar 6 dhe është refuzuar 4;
- 3 projekte në sektorin e TEDA, prej të cilëve janë miratuar 1 dhe është refuzuar 2;
- 1 “Projekt me potencial strategjik”.

Të shprehura në formë grafike:

Në vitin 2023, projektet në sektorin e turizmit zunë 57% të projekteve të miratuara në total, ndërkohë që sektori i agroturizimit zuri 29% dhe 14% të tjera.



Në vitin 2024, projektet në sektorin e turizmit zunë 72% të projekteve të miratuara në total, ndërkohë që sektori i bujqësisë zuri 21% dhe 7% të tjera.



Rezultatet si pasojë e aplikimit të legjislacionit të investimeve strategjike

Duke pasur parasysh aplikimin e legjislacionit për investimet strategjike, si dhe shtimin e numrit të investitorëve që kërkojnë aplikimin e masave asistuese apo mbështetëse nga AIDA dhe shteti shqiptar, duhet theksuar se ka një vlerësim tepër pozitiv mbi kuadrin ligjor ekzistues, pavarësisht se në fillimet e zbatimit të tij, investitorët mund të kenë qenë edhe skeptikë me efektivitetin e zbatimit të këtij ligji. Por sot, është fakt se ky legjislacion është liberal, jo diskriminues për investitorët, qofshin këta vendas apo të huaj, si dhe transparent, në drejtim të incentivave dhe programeve sektoriale, me anë të të cilit janë thjeshtëzuar edhe më tej procedurat administrative.

Tashmë, si pasojë e aplikimit të legjislacionit të investimeve strategjike, projektet e investimit që aplikojnë dhe asistohen nga AIDA kanë më shumë lehtësira në marrjen e lejeve zhvillimore apo lejeve të ndërtimit, kurse masat mbështetëse janë lehtësisht të zbatueshme dhe me procedura të përsheptuara.

Zbatimi i ligjit përgjatë kësaj periudhe ka krijuar një rrjet komunikimi ndërinstitucional shumë funksional. Ligjit të investimeve strategjike Nr.55/2015, i ndryshuar, i ka përfunduar afati i aplikimeve më datë 31.12.2024.

Aktualisht, ky ligj ka hyrë në fuqi duke shtyrë afatin e aplikimeve deri në 31.12.2026.



NDËRMARRJET MIKRO, TË VOGLA DHE TË MESME

Ndërmarrjet Mikro, të Vogla dhe të Mesme (NVM) luajnë një rol kyç në ekonominë e Shqipërisë dhe në zhvillimin e vendit. Kjo shprehet nëpërmjet treguesve të punësimit në sektorin privat dhe kontributit të tyre në të ardhurat kombëtare. Ndërmarrjet e kësaj madhësie ofrojnë një bazë të qëndrueshme për ekonominë vendase dhe janë motori i inovacionit dhe zhvillimit të bizneseve në nivele të ndryshme të shoqërisë. Duke ofruar mundësi për punësim dhe krijimin e të ardhurave, ato ndikojnë në rritjen ekonomike dhe përmirësimin e mirëqenies së popullsisë.

Drejtoria e Projekteve, NVM dhe Eksporte është në përpjekje të kthejë këto potenciale në avantazh konkurrues për ekonominë dhe zhvillimin e qëndrueshëm të vendit.

TREGTIA E JASHTME 2024

Tregtia e jashtme është një ndër shtyllat kryesore të ekonomisë së çdo vendi, pasi ajo mundëson shkëmbimin e mallrave, shërbimeve dhe kapitaleve me partnerë të ndryshëm në mbarë botën. Nga njëra anë, importet sigurojnë plotësimin e nevojave të brendshme për produkte që mungojnë ose janë më pak konkurruese në vend, ndërsa eksportet forcojnë industrinë vendase, rrisin prodhimin kombëtar dhe ndihmojnë në rritjen e të ardhurave.

Vlera e Importit: 9.03 miliardë euro

Importet për vitin 2024 vlerësohen në 9.03 miliardë euro. Kjo shifër nënkupton një kërkesë të lartë të brendshme për mallra të ndryshme, duke përfshirë makineri, pajisje, ushqime dhe materiale ndërtimi.

Partnerët Kryesorë të Importit

Sipas të dhënave të Instat, vendet kryesore nga ku Shqipëria ka importuar gjatë vitit 2024 janë:

- Italia (21.2%)
- Kina (10.9%)
- Turqia (10.8%)
- Greqia (7.6%)
- Gjermania (7.2%)

Prania e Italisë në krye të listës nuk është surprizuese, duke qenë se shumë vende të Ballkanit kanë marrëdhënie historike e tregtare të zhvilluara me Italinë, sidomos në sektorë si ai i tekstileve, makinerive dhe ushqimeve.

Kina dhe Turqia, nga ana tjetër, kanë fituar rëndësi të madhe në tregjet globale falë prodhimit masiv, kostove konkurruese dhe gamës së gjerë të produkteve. Greqia dhe Gjermania konfirmojnë gjithashtu rëndësinë e tyre, sidomos në sektorët e ushqimeve (Greqia) dhe pajisjeve industriale (Gjermania).

Produktet Kryesore të Importit

Tre grupet kryesore të produkteve të importuara gjatë vitit 2024 janë:

1. Makineri, pajisje dhe pjesë këmbimi (26.7%)
2. Ushqime, pije dhe duhan (17.5%)
3. Materiale ndërtimi dhe metale (13.4%)

Fakti që makineritë e pajisjet kryesojnë listën e importeve tregon se industria vendase ose kërkon pajisje bashkëkohore për prodhim, ose nuk ka arritur ende të zhvillojë një sektor kombëtar për prodhimin e këtyre pajisjeve. Kjo kategori lidhet drejtpërdrejt me zhvillimin teknologjik dhe industrial të një vendi.

Ndërkohë, importi i ushqimeve, pijeve dhe duhanit nënkupton që vendi ka nevojë për plotësimin e tregut të brendshëm me produkte bujqësore dhe ushqimore, por edhe preferenca e konsumatorit për produkte të ndryshme ndërkombëtare mund të jetë e lartë.

Kategoria e materialeve të ndërtimit dhe metaleve ka një peshë të konsiderueshme për zhvillimin e sektorit të ndërtimit dhe infrastrukturës, duke reflektuar potencialin e investimeve në këtë sektor dhe nevojën për materiale cilësore nga jashtë.

Vlera e Eksportit: 3.76 miliardë euro

Totali i vlerësuar i eksporteve për vitin 2024 është 3.76 miliardë euro.

Kur krahasojmë këtë shifër me vlerën e importeve, vihet re se ka një diferencë të dukshme prej rreth 5.27 miliardë euro, e cila sinjalizon një deficit tregtar. Kjo do të thotë që vendi importon më shumë sesa eksporton.

Vlera e Eksportit: 3.76 miliardë euro

Në krye të listës së partnerëve kryesorë për eksport figuron sërish Italia, me 43.7% të totalit të eksporteve. Partnerët e tjerë kryesorë janë:

- Kosova (9.9%)
- Greqia (6.3%)
- Gjermania (5.9%)
- Spanja (3.5%)

Rëndësia e Italisë si partner eksportues pasqyron lidhjet e gjata historike dhe gjeografike, por edhe kërkesën e lartë të tregut italian për produkte që mund të ofrohen nga vendi. Kosova zë vend të dytë, ndoshta falë afërsisë gjeografike, marrëdhënieve të ngushta politike dhe tregtare, si dhe kërkesës në rritje për produkte nga rajoni. Greqia, Gjermania dhe Spanja përmbyllin top-listën e destinacioneve kryesore, duke reflektuar një shpërndarje të konsiderueshme të eksporteve brenda Bashkimit Evropian.

Produktet Kryesore të Eksportit

Tre kategoritë kryesore të eksporteve janë:

- Tekstile dhe këpucë (28.2%)
- Minerale, karburante, energji (19%)
- Materiale ndërtimi dhe metale (17.5%)

Tekstilet dhe këpucët janë një shtyllë e rëndësishme e industrisë prodhuese. Shumë kompani ndërkombëtare bashkëpunojnë me fabrika vendase për fasoneri apo prodhim me kosto më të ulët, për t'i shitur më pas në tregjet perëndimore. Kjo shpjegon peshën e lartë të këtij sektori në totalin e eksporteve.

Mineralet, karburantet dhe energjia janë burime të rëndësishme natyrore, të cilat mund të kenë një kërkesë të lartë në tregjet e huaja, sidomos nëse vendi ka rezervat e duhura ose infrastrukturë për nxjerrjen dhe përpunimin e tyre.

Kategoria e materialeve të ndërtimit dhe metaleve mbetet e rëndësishme, jo vetëm për konsum të brendshëm, por edhe për eksport. Nëse vendi ka burime minerare apo një industri përpunimi metalesh, atëherë mund të gjejë tregje të jashtme, sidomos në vendet që kërkojnë lëndë të para ose produkte gjysmë të gatshme për industrinë e tyre.



PLATFORMA “AKSESI NË FINANCË

Përveç funksionit si urë lidhëse midis bizneseve dhe burimeve të financimit, nëpërmjet platformës “Akses në Financë” AIDA promovon mundësitë për financime të reja duke ndihmuar në identifikimin e burimeve të financimit si donacione, subvencione, kredi bankare, ose investime të tjera të kapitalit. Gjithashtu, AIDA ofron dhe grante nga buxheti i shtetit me synimin mbështetjen në mënyrë të drejtpërdrejtë të ndërmarrjeve shqiptare. Kjo mbështetje do të jepet përmes një procesi konkurrues të thirrjes për propozime, i cili do të jetë i konceptuar për të identifikuar dhe financiar projektet që kontribuojnë në rritjen ekonomike dhe krijimin e vendeve të reja të punës.

Platforma “Akses në Financë”

Portali "Akses në Financë" (<https://aida-smefinance.gov.al/>) është një burim i rëndësishëm për bizneset vendase, duke ofruar informacion të përditësuar për mundësitë e burimeve financiare, grantet, kreditë dhe nisma të tjera financiare.

Kjo platformë online siguron një shërbim "one stop shop" me informacione që lidhen drejtpërdrejt me aksesin në financë për Ndërmarrjet Mikro, të Vogla dhe të Mesme (NVM), duke ofruar informacion nga institucione, organizata dhe kompani private dhe publike, si nga nivelet kombëtare dhe ndërkombëtare. Ndërtimi i platformës "Akses në Financë" është realizuar me rekomandimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, dhe ka pasur mbështetjen e Bankës Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH). AIDA, si zbatuesja kryesore e kësaj nisme, ka qenë pjesë e ndjekjes, asistimit dhe kontributit në krijimin e platformës, në bashkëpunim me kompaninë e zhvillimit të saj.

Platforma u lancia në maj të vitit 2021 dhe aktualisht përditësohet rregullisht nga AIDA me thirrje të reja dhe mundësi financimi për bizneset, duke ofruar asistencë dhe përgjigje rast pas rasti për kompanitë e interesuara për të aplikuar.

Deri më tani, në platformë janë publikuar në total 134 thirrje për aplikim për grante ose skema të tjera financiare, duke u vizituar 282,118 herë. Gjatë këtij viti, platforma ka patur 3715 përdorues në total, prej të cilëve 3588 janë përdorues të rinj. Mesatarisht, në platformë publikohen 3-4 thirrje të reja në muaj.

Nga shkalla e frekuentimit, vërehet se thirrjet më të vizituara janë ato që janë fokusuar në inovacion, teknologji dhe arsim. Moshë mesatare e vizitorëve është 25-34 vjeç, ndjekur nga vizitorët e moshës 18-24 vjeç. Vizitorët e platformës janë më së shumti nga Shqipëria, Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Mbretëria e Bashkuar, Italia, Kosova dhe Gjermania. Deri më tani, 1983 subjekte janë regjistruar për të marrë buletin elektronik të thirrjeve, prej të cilave 187 janë NVM dhe 1796 janë persona fizik.

GRANT NGA BUXHETI SHTETIT

AIDA, në zbatim të Ligjit nr. Nr. 43/2022 “Për Zhvillimin E Ndërmarrjeve Mikro, Të Vogla Dhe Të Mesme”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.539, datë 29.07.2022 “Për krijimin, funksionimin, shpërblimin e anëtarëve të bordit vlerësues të kërkesave, si dhe procedurën konkurruese për dhënien e granteve”, të ndryshuar; Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.408, datë 19.06.2024 “Për përcaktimin e masës së përfitimit, kriterëve dhe kushteve të veçanta të përfitimit për ndërmarrjet mikro, të vogla dhe të mesme për vitin 2024”, zhvilloi procesin e përfitimit të fondeve për ndërmarrjet mikro, të vogla dhe të mesme për vitin 2024.

Me qëllim mbështetjen dhe zhvillimin e ndërmarrjeve mikro, të vogla dhe të mesme, për vitin 2024, AIDA administron fondin “Për zhvillimin e ndërmarrjeve”, sipas përcaktimeve të nenit 11, shkronja a, të ligjit nr. 43/2022 “Për ndërmarrjet mikro të vogla dhe të mesme”, i cili financohet nga buxheti i shtetit.

Fondi synon rritjen e konkurrueshmërisë së ndërmarrjeve, zhvillimin e produkteve dëshërbimeve, rinovimin e teknologjisë, zhvillimin e artizanatit si dhe mbështetjen e grave sipërmarrëse me qëllim nxitjen drejt eksportit dhe forcimin e aftësive të tyre lidhur me shërbimet dhe produktet për një treg të qëndrueshëm.

Struktura e “Granteve për mbështetjen e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme” ishte:

- 604 - (shpenzime korente)

231-4(katër) projekteve të financimit: “Fondi i Inovacionit”, “Fondi i Konkurrueshmërisë”, “Fondi Start Up” dhe “Fondi i Ekonomisë Kreative” (shpenzime kapitale).

Skema per shpenzime korrente, fondi limit 100,000,000 lekë

- 1.Certifikimi standardeve të shërbimit/prodhimit (Përfshirë dhe konsulencën përkatëse)
- 2.Pjesëmarrje në trajnime për stafin
- 3.Pjesëmarrje në panaire ndërkombëtare me stendë
- 4.Promovim marke përmes digjitalizimit
- 5.Krijim dhe ndërtim aplikacionesh dhe/ose platformash për E-commerce
- 6.Materiale promovuese (jo më shumë se 20% e vlerës totale të projektit)

Skema për shpenzime kapitale, fondi limit: 51,830,000 lekë

- 1.Projekte për inovacionin
- 2.Projekte për konkurrueshmërinë
- 3.Projekte për Start-Up
- 4.Projekte për Artizanatin

Përgatitje të dokumentacionit për miratim të granteve 2024

AIDA ndërmorri të gjithë hapat e nevojshëm për përgatitjen dhe miratimin e “Fondit për zhvillimin e ndërmarrjeve mikro, të vogla dhe të mesme për vitin 2024”. Pas miratimit nga të gjitha hallkat përkatëse, fondi u çel me 12 Korrik 2024 dhe qendroi i hapur për aplikime deri me 11 Gusht 2024.

AIDA gjithashtu ka prodhuar dhe publikuar në mediat e saj sociale infografe me qëllim rritjen e vizibilitetit të skemës për mbështetje me grant.

Promovim i grantit nëpërmjet zhvillimit të ditëve informuese (5 ditë informuese në qarqet kryesore dhe 1 ditë informuese në zyrat e AIDA-s)

Gjatë kësaj periudhe, me qëllim promovimin e këtij fondi, AIDA, zhvilloi një fushatë informuese, në rang kombëtar, konkretisht në qarqet Tiranë, Korçë, Vlorë, Fier, Shkodër, të cilat u zhvilluan në mënyre hibride (fizikisht dhe online). Pjesë e promovimit të kësaj fushate ishin bashkitë kryesore të vendit.

Me qëllim shpërndarjen e informacionit në sa më shumë biznese, AIDA, krijoi dhe shpërndau broshura informuese të cilat përmbanin një informacion të detajuar mbi hapat kriteret dhe procedurat e aplikimit. Po kështu, thirrja për aplikim për fonde u promovua në mënyrë të vazhdueshme në faqen web të agjencisë si dhe në rrjetet sociale të saj (facebook, instagram, twitter).

Për vitin 2024, u miratua shuma 151,830,000 lekë

| Fondet e AIDA-s | Viti 2024 | | | % realizimit |
|-----------------------------------|-------------------|--------------------|---------------------|--------------|
| | Vlera | Numri I Aplikuesve | Numri I Përfituesve | |
| Fondi i akorduar pas ndryshimeve | 150,030,000 | 355 | 101 | 100% |
| Skema 1 Shpenzime Korrente | 98,200,000 | 162 | 54 | 100% |
| Skema 2 Shpenzime Kapitale | 51,830,000 | 193 | 47 | 100% |
| Konkurrueshmëri | 35,830,000 | 110 | 28 | |
| Inovacion | 5,600,000 | 41 | 6 | |
| Artizanat | 4,800,000 | 14 | 6 | |
| Start up | 5,600,000 | 28 | 7 | |

Përgatitja e raportit final të grantit mbi ecurinë, impaktin dhe problematikat e hasura.

Përfituesit zbatuan projektet gjatë periudhës Shtator-Nëntor 2024 AIDA. Afati për mbylljen e zbatimit të projekteve ishte data 30.11.2024. Për efekt të raportimit dhe monitorimit subjektet në përfundim të projektit dorëzuan raportet për disbursimin e fazës së fundit. Raporti përmbledhës përmbante dëshminë e ndërmarrjes mbi hapat dhe aktivitetet e ndërmarra për zbatimin e projektit, përshkrimin e shpenzimeve të realizuara, impaktin e pritshëm pas zbatimit të projektit si dhe sfidat dhe rezultatet e arritura. Gjithashtu, raporti përmbante fotografi dëshmuese të shpenzimeve të kryera, aktiviteve të realizuara sipas planit të aplikimit të miratuar. Përpos indikatorëve të parashikuar, Drejtoria e Projekteve, NVM dhe Eksporte realizoi gjithashtu edhe një video-dokumentar përmbledhës të të gjithë ecurisë së fondit, si dhe duke përfshirë një pjesë të projekteve të zbatuara nga përfituesit e fondit.

Procesi i grantit pati një ndikim pozitiv tek përfituesit, u zhvillua me sukses dhe arriti objektivat e tij kryesore, duke sjellë një impakt të rëndësishëm në sektorët e synuar konkretisht:

- Përmirësimi i proceseve të biznesit duke integruar elemente të gjelbra dhe/ose digjitale;
- Modernizim të industrisë duke përdorur me efektivitet burimet;
- Rritje të konkurrueshmërisë dhe avantazheve konkurruese në treg;
- Rritje të prodhimit dhe cilësisë së produkteve dhe shërbimit;
- Rritje të shitjeve, të tregut dhe të eksporteve;
- Rritje e përfaqësimit të komponentit femër;
- Rritje të punësimit dhe nxitje të ekonomisë.

NISMA PËR ZHVILLIMIN E SIPËRMARRJEVE MIKRO, TË VOGLA DHE TË MESME

Zhvillimi i tre tryezave të rrumbullakëta

Me qëllim rritjen e aftësive konkurruese dhe inovative të Ndërmarrjeve të Vogla e të Mesme, nxitjen dhe promovimin e eksporteve, AIDA gjatë muajit prill 2024, si muaji i dedikuar NMV-ve shqiptare, në ambjentet e saj, organizoi 3 tryeza të rrumbullakta me qëllim identifikimin e nevojave të kompanive të sektorëve si: “Verë”, “Lëkurë Këpucë” dhe “Vaj Ulliri, Mjalt, Prodhime të Përpunimit të Qumështit”.

Zhvillimi i këtyre tryezave kishte në fokus nxitjen, përfshirjen e aktorëve dhe përfaqësuesve të bizneseve të këtyre sektorëve për identifikimin e nevojave, problematikave, me qëllim nxjerrjen e konkluzioneve dhe adresimin e rekomandimeve pranë institucioneve përkatëse.

Në këto tryeza diskutimi, morrën pjesë përfaqësues nga Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, shoqata dhe biznese të këtyre sektorëve si dhe partnerë të AIDA-s, SIPPO Albania.

Konkretisht:

- Tryeza e rrumbullakët me prodhuesit e sektorit të Verës, datë 09.04.2024;
- Tryeza e rrumbullakët me prodhuesit e sektorit të Lëkurë Këpucës, datë 16.04.2024;

- Tryeza e rrumbullakët me prodhuesit e sektorit të Bimëve Aromatike dhe Medicinale, datë 23.04.2024.

Trajnime/Workshope

- AIDA, ka marrë pjesë në 12 seanca trajnime në kuadër të projektit “Ngritja e kapaciteteve të AIDA për Kërkimin e Tregut”, organizuar nga GIZ Albania, për periudhën dhjetor 2023 - prill 2024.
- Pjesëmarrje në workshopin e organizuar nga SIPPO Albania, me qëllim rritjen e kapaciteteve të AIDA-s në eksport, në datat 15 dhe 16 prill 2024.
- Pjesëmarrje në trajnime organizuar nga Damiani&Partners, së bashku me GIZ Albania në kuadër të projektit: “Përmirësim i promovimit të eksporteve tek AIDA”
- Në kuadër të projektit “Përmirësim i promovimit të eksporteve tek AIDA”, stafi i AIDA-s, zhvilloi 3 seanca workshopi me NVM-të shqiptare, mbi shërbimet e ofruara në mbështetje të NVM-ve, me tema: “Panaiet ndërkombëtare dhe rëndësia e pjesëmarrjes së bizneseve shqiptare”, “Misionet tregtare, si mundësi për zgjerimin në tregje të reja” dhe “Platforma dhe strategji për organizimin e takimeve B2B dhe matchmaking”, në datat 5-7 shkurt 2025.
- Pjesëmarrje dhe kontribute në grupe pune ndër-institucionale, kapitulli 20 “Ndërmarrjet dhe Politikat Industriale”, dhe aktorë në ekosistemin e sipërmarrjeve.
- Pjesëmarrje në takimet e monitorimit të strategjisë BIDS dhe planit të veprimit 2021-2027.
- Pjesëmarrje në workshopin për zhvillimin e strategjisë së industrisë, organizuar në MEKI, me mbështetjen e UNOPS.
- Workshop i organizuar nga AIDA-DPPI me kompanitë e sektorit 21 mars 2024, me temë “Si të rrisni vlerën e biznesit tuaj përmes pronësisë industriale”
- Pjesëmarrje në workshopin “Mundësi për biznesin për akses në Grante Evropiane”, organizuar nga Organizatat koordinatorë të Enterprise Europe Network në Shqipëri dhe Centre for Competitiveness Promotion dhe Prishtina REA Kosovë në datën 28 mars 2025.



Platforma Eksporteve

AIDA, në bashkëpunim me German Agency for International Cooperation (GIZ), ka filluar ndërtimin e Platformës së Eksporteve (Exportalbania.al) e cila do të shërbejë për të fuqizuar bizneset shqiptare në ekspozimin dhe penetrimin në tregje globale. Kjo platformë është konceptuar si një zgjidhje strategjike për të mbështetur ndërkombëtarizimin e ndërmarrjeve mikro, të vogla dhe të mesme, duke përfunduar misionin e AIDA-s për të ofruar shërbime me vlerë të shtuar që lidhen ngushtë me eksportin dhe rritjen e aktivitetit tregtar të sipërmarrjeve shqiptare në tregjet ndërkombëtare. Platforma pritet të përfundojë dhe të promovohet brenda muajit mars 2025.

KONFERENCA, FORUME DHE TAKIME

- Pjesëmarrje në Tryezën e Bashkëpunimit Rajonal në edicionin e 30 të Tiranë International Fair, me temë “Lehtësimi i barrierave financiare për tregtinë mes vendeve të Ballkanit dhe më gjerë”, në datë 6 nëntor 2024, në Tiranë;
- Pjesëmarrje në konferencën mbi sektorin e “Bimëve Aromatike dhe Mjekësore (BAMs) në Shqipëri”, organizuar nga Universiteti Bujqësor i Tiranës (UBT), në bashkëpunim me shoqatat e sektorit MAP, dhe me mbështetjen e RisiAlbania, një projekt i Agjencisë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC), zbatuar nga Helvetas në datën 14 nëntor 2024;
- Organizim dhe pjesëmarrje për herë të parë në misionin tregtar në bashkëpunim me Ambasadën Shqiptare në Poloni dhe PAIH (Polish Trade and Investment Agency) dhe 2 kompani shqiptare, në datat 18-19 nëntor 2024, në Varshavë;
- Pjesëmarrje në Workshop-in “Mbi teknologjitë e prodhimit dhe digjitalizimin e prodhimit”, si pjesë e programit AMTECH, mbështetur nga Interreg IPA i Adriatikut të Jugut, organizuar nga shoqata PROEKSPORT Albania, në datë 26 nëntor 2024, në Tiranë;
- Pjesëmarrje në takimin rajonal për Industrinë Tekstile me Vlerë të Shtuar në Ballkan, organizuar nga SIPPO Albania dhe organizatat e Ballkanit, si shoqata, dhoma e tregtisë së Maqedonisë së Veriut, Serbisë, Bosnje Hercegovinës, në datat 3-6 dhjetor 2024, në Sarajevë, Bosnje dhe Hercegovinë;

- Pjesëmarrje në takimin e parë të Këshillit Konsultativ të Ndërmarrjeve (KKN), pranë Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit (MEKI) në datë 12 dhjetor 2024;
- Pjesëmarrje në takimin e organizuar nga CEEC Expo në bashkëpunim me MPEJ, rreth mundësisë së pjesëmarrjes në “The 4th China-CEEC Expo & International Consumer Goods Fair”.

PANAIRET DHE AKTIVITETET: MBËSHTETJE NË RITJEN E KONKURRUESHMËRISË DHE PROMOVIMIT TË NMVM-VE.

Një nga funksionet e AIDA-s është forcimi i konkurrueshmërisë dhe pranisë së kompanive shqiptare në tregjet kombëtare dhe ndërkombëtare.

AIDA me qëllim rritjen e konkurrueshmërisë, nxitjen e eksporteve, si edhe promovimin e bizneseve shqiptare, ka organizuar dhe marrë pjesë në: 7 panaire, 4 ndërkombëtare dhe 3 kombëtare, në sektorët kyç të ekonomisë si: Pije Ushqim, Bimë medicinale dhe aromatike, Fruta -Perime, Vaj Ulliri dhe Tekstile. Gjithësej u mbështetën 51 kompani shqiptare.

AIDA shërben si urë lidhëse për bizneset shqiptare, duke koordinuar të gjitha aspektet e pjesëmarrjes dhe duke siguruar që kompanitë të kishin infrastrukturën e nevojshme për të prezantuar produktet e tyre në mënyrë efektive.

Gjithashtu, AIDA ndihmoi bizneset shqiptare në gjetjen e partnerëve të huaj dhe në zhvillimin e marrëdhënieve të biznesit me qëllim të rritjes së eksporteve dhe për të bërë produktet shqiptare më të njohura në tregjet ndërkombëtare.

Panairet ku AIDA planifikon të marrë pjesë si ekspozitor janë publikuar në faqen web, si dhe në të gjitha mediat sociale të komunikimit. Pjesëmarrja në këto panaire realizohet përmes shprehjes së interesit nga ana e kompanive, në adresën zyrtare të AIDA-s dhe vlerësimit në vijim të kriterëve përmbushëse.

Pjesëmarrja në panaire ndërkombëtare dhe kombëtare solli histori suksesi dhe nënshkrim të marrëveshjeve tregtare, duke rritur eksportet dhe të ardhurat për bizneset shqiptare.

Përmbledhje e panairove dhe aktiviteteve mbështetëse të organizuara nga AIDA:

- “Biofach 2024”, datat 13-16 Shkurt 2024, Nuremberg, Gjermani.

Në këtë panair morrën pjesë 6 kompani, 5 kompani nga sektori i bimëve medicinale dhe aromatike dhe 1 kompani nga sektori i vajit të ullirit. Kompanitë realizuan 423 kontakte me kompani të huaja, 88 kontrata potenciale për një vlerë potenciale prej 7.565.000 Euro.

- MoMad - 13-15 shtator, në Madrid, Spanjë.

Në këtë panair morrën pjesë 4 kompani, 3 kompani nga sektori tekstil dhe 1 kompani nga sektori lëkurë këpucë. Kompanitë realizuan 25 kontakte me kompani të huaja dhe 10 kontrata potenciale.

- GagFestival – 2-3 tetor 2024, Berlin, Gjermani.

Në këtë panair morrën pjesë 5 kompani, 3 kompani nga sektori i verës dhe birrës dhe 2 kompani të vajit të ullirit. Kompanitë realizuan 18 kontakte me kompani të huaja, 10 kontrata potenciale.

- FI North – 30-31 tetor 2024, në Las Vegas, SHBA.

Në këtë panair morrën pjesë 8 kompani pjesëmarrëse, 6 kompani nga sektori i bimëve medicinale dhe aromatike dhe 2 kompani nga sektori i vajit të ullirit. Kompanitë realizuan 399 kontakte me kompani të huaja, 102 kontrata potenciale për një vlerë potenciale prej 2.210.000 dollarë.

- Panairi “Ditet e Bujqësisë”- 24-26 prill 2024, Lushnje.

AIDA morri pjesë me stendë ku promovoi shërbimet e agjencisë në mbështetje të NMVM-ve shqiptare.

- Panairi “Agro Tech & Natyral Ekspo”- datat 16-18 maj 2024, Farkë,

Në këtë panair morrën pjesë 10 kompani, 3 kompani të produktit mjalt, 2 kompani të produktit djath, 1 kompani e produktit vezë, 2 kompani të verës, 2 kompani nga artizanati.

- Panairi Ndërkombëtar i Tiranës- datat 6 - 9 nëntor 2024.

Në këtë panair morrën pjesë 8 kompani, 3 kompani të artizanatit, 4 kompani të sektorit pije dhe ushqim, 1 kompani konsulence punësimi.

MBËSHTETJA E PRODUKTIT 'ZGJIDH TË VËNDIT'

Promovimi i Produkteve Vendase në Kuadër të Fushatës

Fushata “Zgjidh të Vendit” ka vijuar si një iniciativë e rëndësishme për promovimin e produkteve shqiptare, duke mbështetur dhe fuqizuar prodhuesit vendas në sektorë të ndryshëm. Gjatë periudhës Janar – Dhjetor 2024, fushata është shtrirë në disa aspekte kyçe, përfshirë promovimin në rrjete sociale, organizimin e eventeve dhe publikimin e katalogut dedikuar biznesit vendas.

Në kuadër të “Zgjidh të Vendit”, është realizuar një analizë dhe identifikim i produkteve shqiptare në kategori të ndryshme sektoriale. Synimi kryesor ka qenë rritja e ndërgjegjësimit të konsumatorëve mbi gamën e gjerë të produkteve vendase, duke i ofruar një platformë të përbashkët promovimi dhe ekspozimi.

Përmes një **strategjie të mirëfilltë të komunikimit dhe marketingut**, fushata është prezantuar gjerësisht në mediat sociale të AIDA-s, duke krijuar një rrjet të qëndrueshëm informimi mbi markat shqiptare dhe avantazhet e tyre në tregun vendas e ndërkombëtar.

Eventi Kryesor – Maj 2024

Pjesë e strategjisë për promovimin e prodhimeve vendase ka qenë dhe organizimi i një eventi të dedikuar në **Maj 2024**, ku u angazhuan një numër i konsiderueshëm **biznesesh shqiptare, përfaqësues të mediave dhe aktorë të ndryshëm të ekosistemit të zhvillimit ekonomik**. Ky event shërbeu si një pikë takimi për **ndërmarrjet e vogla dhe të mesme (NVM)**, duke i dhënë mundësinë prodhuesve shqiptarë të prezantojnë produktet e tyre, të krijojnë kontakte të reja biznesi dhe të diskutojnë mbi sfidat dhe mundësitë e tregut.

Publikimi i Katalogut “Zgjidh të Vendit”

Në kuadër të fushatës, është publikuar katalogu “Zgjidh të Vendit”, një botim që përmbledh informacion mbi rreth **100 biznese vendase**, duke prezantuar:

1. Përshkrimin e aktivitetit të tyre
2. Kapacitetet e prodhimit
3. Produktet që ofrojnë për tregun vendas dhe ndërkombëtar

Katalogu synon të shërbejë si një **mjet promovimi** për bizneset shqiptare, duke i bërë ato më të aksesueshme për partnerët potencialë, investitorët dhe distributorët vendas e të huaj. Ai është shpërndarë nëpër kanalet zyrtare të AIDA-s dhe është përdorur si një material referues në takime dhe evente ndërkombëtare për të nxitur eksportin dhe investimet në prodhimin vendas.

“Zgjidh të Vendit” është shndërruar në një iniciativë kyçe për fuqizimin e sektorit prodhues në Shqipëri, duke përçuar mesazhin e rëndësisë së konsumimit të produkteve vendase dhe duke ndihmuar bizneset shqiptare të pozicionohen më mirë në treg. Përmes eventeve të organizuara dhe katalogut informues, kjo fushatë ka kontribuar ndjeshëm në **rritjen e ndërgjegjësimit, krijimin e partneriteteve të reja dhe zgjerimin e mundësive për zhvillimin ekonomik të vendit.**

PROJEKTE TË MENAXHUARA NGA AIDA

Gjatë vitit 2024, AIDA ka vijuar me menaxhimin dhe implementimin e projektit “Aftësi për Punësim të Qëndrueshëm dhe Rritje Ekonomike Gjithëpërfshirëse të Rajonit Ndërkufitar të Shqipërisë dhe Malit të Zi – Aftësi për Punësim Shqipëri – Mal i Zi”, pjesë e programit IPA II 2014-2020 të financuar me fonde nga Bashkimi Europian, ka mbështetur individë dhe ndërmarrje mirko, të vogla dhe të mesme nëpërmjet thirrjeve të ndryshme për aplikim, në kuadër të zbatimit të projektit.

Qëllimi kryesor i këtij projekti është nxitja e punësimit dhe përfshirja sociale duke lehtësuar hyrjen në tregun e punës për të rinjtë dhe gratë në zonat ndërkufitare të Shqipërisë dhe Malit të Zi.

Target-grupi i synuar përfshin punëkërkesit me nivel të ulët dhe të mesëm arsimimi, nivel të ulët kualifikimi dhe me aftësi që nuk përputhen me kërkesën e tregut të punës, të rinjtë (mosha 15 deri në 29 vjeç) dhe gratë që kërkojnë punësim.

AIDA është pika kryesore e të gjitha aktiviteteve që zhvillohen në Shqipëri, që nga identifikimi dhe koordinimi i pjesëmarrësve në trajnim dhe mentorim, si dhe punëdhënësve dhe bizneseve që do të përfshihen në këtë projekt.

Aktivitetet e përfshira në implementimin e këtij projekti realizohen mes Shqipërisë (Bashkia Shkodër, Bashkia e Vaut të Dejës, Bashkia e Malësisë së Madhe) dhe Malit të Zi (Podgoricë, Tuz, Budva, Bar, Ulqin, Danilovgrad dhe Cetinje). Kohëzgjatja totale e implementimit të këtij projekti është 24 muaj, duke filluar nga muaji Shkurt 2023.

Gjatë vitit 2024, AIDA mbështeti target-grupin e synuar nëpërmjet ofrimit:

- Trajnim profesional për udhërrëfyes turistik kombëtar: Duke qënë se turizmi është një sektor prioritar për zhvillimin e zonave të përfshira në projekt, kurset e trajnimit profesional për udhërrëfyes turistik janë një mundësi e mirë të rinjtë për të zhvilluar aftësitë e tyre profesionale dhe për të qënë të punësueshëm gjatë sezonit turistik. Trajnimi zhvillohet nga një subjekt i licensuar për ofrimin e këtij trajnimi, i përzgjedhur nëpërmjet një thirrjeje për aplikim të dedikuar, dhe u ofrohet në total 5 individëve të përzgjedhur. Trajnimi ka filluar që prej muajit Shkurt 2024 dhe kohëzgjatja totale e tij është 4 muaj duke përfshirë të mësuarit teorik, si dhe atë praktik. Në përfundim të trajnimit, individët do të pajisen me certifikata pjesëmarrjeje.
- Thirrje për aplikime “Për përzgjedhjen e mentorëve për ofrimin e shërbimit të trajnimit me qëllim aftësimin e të rinjve (mosha 15-29 vjeç) dhe gra të papuna për krijimin e planeve të biznesit dhe fillimin e një biznesi, në Bashkitë Shkodër, Vaut i Dejës dhe Malësi e Madhe.

- Thirrje për aplikime “Për ofrimin e shërbimit të mentorimit për aksesin në financë dhe simulim në paraqitjen e ideve të biznesit.
- Thirrje për aplikime “Për të qenë pjesë e trajnime për zhvillimin e aftësive sipërmarrëse, për 15 pjesëmarrës të rinj (mosha 15-29 vjeç) dhe gra të papuna në Bashkitë Shkodër, Vau i Dejës dhe Malësi e Madhe. Në përfundim të zhvillimit të këtyre thirrjeve, u përzgjedhën 7 mentorë dhe 11 të rinj për të qenë pjesëmarrës në trajnime në fushat si: Aspekte ligjore dhe regjistrimi i biznesit, Menaxhimi financiar dhe kontabiliteti, Planifikimi strategjik dhe krijimi i modelit të biznesit, Marketingu dhe shitjet, Marketing dixhital/ përmbajtje, Aksesi në finance, Simulim në paraqitjen e ideve të biznesit. Trajnimet u zhvilluan në formën teorike dhe praktike, për periudhën prill-qershor 2024. Në përfundim të këtyre trajnimeve nga të rinjtë pjesëmarrës u përzgjedhën 5, të cilët prezantuan plane biznesi si më të vlerësuara për fillimin e një biznesi. Nga këto, dy subjekte realizuan me sukses termat e kontratës për dhënien e grantit.
- Realizimi i një Video dokumentari, që dokumenton zhvillimin dhe prezantimin e ideve dhe plan bizneset, të zhvilluara nga 7 mentorët e kontraktuar nga AIDA për ofrimin e shërbimit të trajnimit, zhvillimit të ideve dhe modeleve të biznesit nga ana e pjesëmarrësve në trajnim, si dhe përgatitjes dhe prezantimit të ideve të biznesi të zhvilluara në periudhën prill-qershor 2024. Gjithashtu, është bërë i mundur përkthimi i video-dokumentarit me titra në anglisht.
- Panairi i Biznesit gjatë datave 22-23 tetor 2024, në Budva. Stafi i projektit së bashku me 5 kompani të sektorit të artizantatit dhe turizimit morrën pjesë në Panairin e Biznesit si pjesë e konferencës vjetore që u zhvillua në bashkëpunim me Dhomën e Ekonomisë dhe Fondacionit Business Start Center Bar, me qëllim promovimin e produkteve të kompanive pjesëmarrëse dhe organizimin e takimeve B2B me partnerë potencialë të këtyre sektorëve.
- Paniri i Biznesit, mbajtur në Shkodër, 21 Janar 2025.

Stafi i projektit organizoi panairin e kthimit të biznesit në qytetin e Shkodrës, ku 10 biznese nga Shqipëria dhe 15 biznese nga Mali i Zi, pjesë e sektorëve prioritarë të këtij projekti, u bënë bashkë në formatin e një mini-panairi, ku secila kompani pati mundësinë të prezantonte aktivitetin e saj, si dhe të krijonte ura bashkëpunimi nëpërmjet takimeve B2B me partnerë potencialë nga Mali i Zi, me qëllim fundor krijimin e një marke të përbashkët CBC MNE-ALB.

- Konferenca përmbyllëse e projektit, realizuar më datë 22 Janar 2025 në Shkodër. Konferenca përmbyllëse, e mbajtur më 22 janar 2025 në Hotel Golden Palace në Shkodër, mbledhi së bashku zërat kyç institucionalë për të reflektuar mbi rezultatet dhe ndikimin e projektit ndërkufitar. Konferenca u hap me fjalët e përfaqësuesve të AIDA-s, BSC Bar dhe Dhomës së Tregtisë së Malit të Zi, duke i dhënë tonin një dite prezantimesh dhe diskutimesh të thella. Z. Bekim Mema, Drejtor i Përgjithshëm i Zhvillimit të Qëndrueshëm Ekonomik në Bashkinë Shkodër, foli për rëndësinë e projektit me strategjitë e zhvillimit lokal. Atij iu bashkua edhe znj. Entela Kolaj, përfaqësuese e Bashkisë Vau i Dejës, e cila vuri theksin në iniciativat e turizmit dhe trashëgimisë kulturore. Z. Eristjan Smajlaj, Drejtues i Zhvillimit të Turizmit për Malësinë e Madhe, theksoi kontributin e projektit në turizmin e qëndrueshëm rajonal. Gjithashtu, i ftuar nga Mali i Zi, PhD Mladen Perazić, Drejtor i Sektorit për Arsim në Dhomën e Ekonomisë, prezantoi perspektivat për bashkëpunimin rajonal dhe zhvillimin e aftësive. Secili folës nënvizoi rëndësinë e zbatimit lokal të përshtatur dhe sinergjisë ndërkufitare. Konferenca përfundoi me shfaqjen e një video-dokumentari që tregon etapat e projektit dhe një sesion rrjetëzimi që nxiti dialogun e mëtejshëm midis palëve të interesuara. Ngjarja shënoi me sukses mbylljen formale të iniciativës duke rikonfirmuar rrugët e ardhshme për bashkëpunim.

EEN ALBANIA

Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve (AIDA) është koordinatori i rrjetit **Enterprise Europe Network (EEN) Albania**, një iniciativë kyçe për mbështetjen dhe zhvillimin e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme (SME) në Shqipëri. Ky projekt, i financuar nga **Komisioni Evropian**, synon të ndihmojë bizneset shqiptare në rritjen e tyre, internacionalizimin dhe forcimin e inovacionit përmes shërbimeve të personalizuar dhe platformave të dedikuara.

Objektivat Kryesore të EEN Albania

- **Internacionalizimi i SME-ve Shqiptare** – Ndhmon bizneset në identifikimin e partnerëve të huaj, qasjen në tregje të reja dhe rritjen e eksporteve.
- **Inovacion dhe Teknologji** – Ofron asistencë për përmirësimin teknologjik të ndërmarrjeve, si dhe akses në programet e financimit për inovacionin.
- **Akses në Financa dhe Burime** – Informon dhe asiston SME-të mbi mundësitë e financimit, grantet dhe investimet e huaja.
- **Pjesëmarrje në Panaire dhe B2B Evente** – Ofron mundësi për bizneset që të marrin pjesë në takime ndërkombëtare, matchmaking events dhe panaire sektoriale.

Rezultate dhe Ndikimi

Përmes EEN Albania, AIDA ka ndihmuar SME shqiptare të marrin pjesë në takime ndërkombëtare, të krijojnë bashkëpunime strategjike dhe të përfitojnë nga fondet evropiane. Nëpërmjet aktiviteteve të ndryshme, si B2B matchmaking, informime mbi rregulloret e BE-së dhe ndihma për certifikimin e produkteve, rrjeti EEN ka qenë një katalizator për zhvillimin ekonomik dhe konkurrueshmërinë e SME-ve shqiptare.

Në vijim, AIDA do të vazhdojë të zgjerojë mbështetjen për bizneset shqiptare duke forcuar lidhjet me rrjetet evropiane dhe duke krijuar mundësi të reja për ndërmarrjet që synojnë rritjen dhe zgjerimin ndërkombëtar.



KOMUNIKIMI DHE IMAZHI PUBLIK I INSTITUCIONIT

Gjatë vitit 2024 janë ndërmarrë një sërë nismash për të tërhequr vëmendjen e investitorëve potencialë, duke nxjerrë në pah jo vetëm ekspertizën dhe përvojën e konsoliduar të Agjencisë, por edhe avantazhet konkrete që ofron investimi në projekte të zgjedhura dhe në sektorë prioritarë të ekonomisë shqiptare. Komunikimi i këtyre vlerave është realizuar përmes krijimit dhe shpërndarjes së materialeve profesionale të marketingut, përfshirë broshura investimi, prezantime vizuale dhe video promovuese, të cilat janë konceptuar për të theksuar veçoritë unike të tregut shqiptar dhe potencialin që ofron vendi për investime të qëndrueshme dhe afatgjata. Ky angazhim i vazhdueshëm ka synuar ndërtimin e një imazhi të besueshëm dhe tërheqës për Shqipërinë si një destinacion konkurrues për investitorët vendas dhe të huaj.

Faqja Web e AIDA-s

Faqja Web është dritarja kryesore e komunikimit publik të Agjencisë Shqiptare të Zhvillimit të Investimeve. Gjatë vitit 2024 AIDA erdhi me një faqe të re zyrtare Web e konceptuar për të qenë sa më inovatore në dizajn dhe përmbajtje. Njëkohësisht kjo risi në faqen zyrtare të web mundësoi një eksperiencë më interaktive dhe tërheqëse për vizitorët e faqes. Një nga risitë e kësaj faqeje të re web ishte edhe “Albania Smart Map”, një hartë inteligjente e Investime Strategjike të Shqipërisë, me projektet e asistuar nga AIDA, me qëllimin që, vizitorët e faqes të zbulojnë Shqipërinë dhe të njihen me potencialin e saj të investimeve.

Faqja Web e AIDA-s, përmban informacione të rëndësishme në ndihmë të investitorëve të huaj dhe shqiptarë, kompanive vendase, si edhe ato të huaja. Drejtoria Marketing është angazhuar në menaxhimin dhe përditësimin e përmbajtjes së faqes zyrtare të web-it të Agjencisë, www.aida.gov.al, kontenti i së cilës ofrohet në gjuhën shqipe dhe angleze. Përditësimi i faqes zyrtare bëhet në baza të rregullta duke reflektuar praktikën më të mira ndërkombëtare dhe nëpërmjet një marketingu miksi synon rritjen e numrit të investitorëve potencialë për të vizituar faqen. Gjatë vitit 2024, faqja zyrtare web ka pasur një numër prej 8507 vizitorësh, nga vendi ynë dhe sidomos nga vendet e huaja. Cdo vit shtohen feature-s të rinj për përdorim sipas strukturës së eventeve dhe strategjive që ka AIDA, duke bërë kështu të mundshme lehtësimin e komunikimit dhe të regjistrimeve të një numri shumë të madh të interesuarish për eventet që realizon AIDA. Në total numri i vizitorëve ishte 17,581 nga ku 64.57% e vizitorëve ishin nga Shqipëria dhe 35.43% nga vende të huaja. Ndër vizitorët e vendeve të huaja, kryesonin ata nga Franca (5.35%), nga SHBA (4.33%), nga Italia (3.1%), nga Kosova (2.61%) dhe nga Gjermania (2.44%).

Publikime në media sociale

Drejtoria e Marketingut ka mundësuar në vazhdimësi gjatë gjithë vitit përditësimin me informacion, si edhe pasqyrimin në kohë, në të gjitha kanalet e komunikimit (Website, Facebook, Instagram, LinkedIn, X) të aktiviteteve apo rekordeve që kanë të bëjnë me aktivitetin e Agjencisë. Të gjitha aktivitetet, takimet zyrtare, konferencat, trajnimet, seminare dhe panairët, janë pasqyruar në faqen Web dhe në Rrjetet Sociale të agjencisë me qëllim informimin e publikut në mënyrë transparente dhe në kohë reale.

Publikimet janë realizuar në gjuhën shqipe dhe angleze, si edhe shoqërimi i tyre me foto, video dhe infografe ilustruese, nga aktivitetet. Të gjitha postimet në rrjetet sociale janë të shoqëruara me link nga faqja zyrtare e AIDA-s, në mënyrë që të promovohet faqja zyrtare e institucionit, si edhe për ta bërë më të aksesueshme nga publiku. Drejtoria Marketing ka ndjekur dhe monitoruar të gjitha informacionet mbi veprimtarinë e AIDA-s, grupeve të interesit, investitorëve, partnerëve dhe ka informuar publikun e gjerë nëpërmjet mediave elektronike dhe faqes zyrtare www.aida.gov.al në kohë reale. Një rëndësi të veçantë i është kushtuar organizimit të aktiviteteve dhe përmirësimit të imazhit duke siguruar që të dhënat, lajmet dhe materialet promovuese të Agjencisë të shpërndahen në mënyrë periodike nëpërmjet rrjeteve sociale dhe faqes zyrtare të internetit.

Rrjete sociale

AIDA mbulon me informacione edhe nëpërmjet rrjeteve sociale, për t'ju ardhur në ndihmë palëve të interesuara, si dhe për ta bërë më të lehtë marrjen e informacionit.

Aktualisht AIDA ka në përdorim faqet: Facebook - AIDA - Albanian Investment Development Agency, Instagram - @aida__albania, LinkedIn - AIDA - Albanian Investment Development Agency, X - @investinalbania.

AIDA Facebook Faqja e facebook ka një audiencë të lartë, numër i cili ka ardhur duke u rritur vazhdimisht. Faqja facebook përditësohet vazhdimisht duke ofruar informacione mbi aktivitetet e ardhshme dhe të zhvilluara, mbi investimet dhe klimën e të bërit biznes, rritjen ekonomike etj. Për vitin 2024 janë bërë 351 postime, ndër të cilat 265 ishin lajme dhe 86 reels, për evente, takimet zyrtare, konferencat, trajnimet, seminare dhe panairët.

AIDA X-AIDA është aktive edhe në rrjetin social X, duke publikuar dhe ndarë me ndjekësit informacione të rëndësishme. Për vitin 2024, janë bërë 108 postime gjithsej. Faqja zyrtare AIDA-s, së bashku me rrjetet sociale (Facebook, X, Instagram, LinkedIn), kanë qënë shumë aktive dhe një asistencë e rëndësishme për të gjithë aktorët dhe bizneset të cilët vizitojnë faqen zyrtare dhe rrjetet sociale të AIDA-s, për tu njohur në kohë reale me të gjitha informacionet e pasqyruara. Në total, në të gjitha adresat e AIDA-s janë bërë 943 postime.

AIDA Instagram, Agjencia ka në përdorim edhe një faqe instagrami, për informim të të gjithë palëve të interesuara mbi shërbimet dhe rolin e institucionit, si edhe për njohje nga një masë me e gjerë. Për vitin 2024, janë bërë gjithsej 351 publikime.

AIDA LinkedIn, AIDA ka aktualisht dhe një faqe në rrjetin social LinkedIn për të qënë më afër ndjekësve të saj. Për vitin 2024, në rrjetin social LinkedIn janë bërë 133 postime.

Prezantimet video

AIDA përgjatë vitit 2024 ka përgatitur një video profesionale e realizuar me outsource e cila shpërfaq Agjencinë si aktorin kryesor one-stop-shop për investimet e huaja por edhe si institucionin qendror shqiptar për informimin e NMVM-ve vendase. Kjo video gjendet në faqen web të AIDA-s por edhe është përdorur gjerësisht në aktivitetet e organizuar nga AIDA dhe jo vetëm për të promovuar punën e institucionit. Kjo video prezanton edhe Agjencinë, video është realizuar në zyrat e AIDA-s në ambiente biznesi dhe ka po ashtu edhe pamje nga vizitat e AIDA-s në kompani dhe pamje të investimeve.

BOTIMET E AIDA-S

Përgjatë vitit 2024, në kuadër të rritjes së vizibilitetit dhe informimit, AIDA ka hartuar dhe dizenuar materiale promovuese (digjitale dhe fizike), me fokus investitorët potencialë dhe kompanitë NMVM. Botimet prezantojnë dhe promovojnë misionin dhe qëllimin e institucionit, si dhe pasqyrojnë informacione të rëndësishme mbi ekonominë e vendit tonë, sektorëve potencialë për investime, si edhe iu vijnë në ndihmë kompanive NMVM, për t'u zgjeruar në tregun e huaj. Drejtoria Marketing në bashkëpunim me drejtoritë e tjera siguroi përditësimin e materialeve dhe u kujdes për përshtatjen, dizenjimin, botimin dhe vendosjen e tyre në faqen zyrtare të internetit të Agjencisë, për t'i bërë sa më të aksesueshme. Një rëndësi ju kushtua cilësisë së përmbajtjes së informacionit të materialeve promovuese, si dhe plotësimin të kërkesave të legjislacionit në fushën e botimit.

Leaflet Invest in Albania

Fletëpalosja është konceptuar si ftesë nga AIDA për të lënë takimin tuaj në Agjenci për të bërë realitet planin tuaj për investim në vendin tonë. Për më shumë informacion, fletëpalosjen e gjeni online në faqen tonë zyrtare www.aida.gov.al në rubrikën <Publikime> / Link: <https://aida.gov.al/wp-content/uploads/2024/12/aeroport.pdf>

Bring your Business to Albania 2024

Broshura përmban informacione mbi arsyet pse të investosh në Shqipëri, ligjin mbi investimet strategjike dhe investimet e huaja, skemën 1 Euro, incentivat për punësim si edhe incentivat për sektorët potencial, si: energjia, turizmi, agroturizimi, manifaktura, bujqësia dhe për Zonat e Teknologjisë dhe Zhvillimit Ekonomik (TEDA). Broshura sjell të dhëna mbi arritjet e realizuara vitet e fundit për sektorët potencialë.

Për më shumë informacion, broshurën e gjeni online në faqen tonë zyrtare www.aida.gov.al në rubrikën <Publikime> / Link: <https://aida.gov.al/wp-content/uploads/2024/05/Bring-your-Business-to-Albania-2024-1.pdf>

Albania Calls 2024

Botimi përmban informacione të përditësuara mbi arsyet kryesore për të investuar në Shqipëri, klimën e biznesit, marrëveshjet e tregtisë së lirë, bazën ligjore për investimet e huaja dhe indikatorët makroekonomik. Incentivat dhe të dhënat për sektorët kryesorë të investimit, si: turizmi, manifaktura, bujqësia, transporti dhe logjistika, shërbimet BPO dhe Zonat e Teknologjisë dhe Zhvillimit Ekonomik (TEDA). Broshura sjell pamje nga atraksione të ndryshme turistike dhe kulturore të Shqipërisë.

Për më shumë informacion, broshurën e gjeni online në faqen tonë zyrtare www.aida.gov.al në rubrikën <Publikime> / Link: <https://aida.gov.al/wp-content/uploads/2024/04/AIDA-Albania-Calls-2024.pdf>

Booklet Invest in Albania

Katalogu Invest in Albania 2024 pasqyron një përmbledhje të gjithë botimeve që AIDA ka krijuar për t'i ardhur në ndihmë investitorëve. Përmbajtja e saj ofron akses në informacionin e përditësuar dhe lehtëson komunikimin efikas me individët, ndërmarrjet apo investitorët. Katalogu ju jep mundësinë të skanoni QR Code që ju çon në botimin e plotë në web.

- ALBANIA CALLS: “A COUNTRY OF OPPORTUNITIES”;
- BRING YOUR BUSINESS TO ALBANIA;
- FACTSHEET RENEËABLE ENERGYSECTOR;
- FACTSHEET AGRICULTURE, AGRITOURISM AND AQUACULTURE SECTOR
- FACTSHEET MANUFACTURESECTOR;
- FACTSHEET TOURISM SECTOR;
- FACTSHEET ICT AND BPO SECTOR;
- FACTSHEET TEDA;
- INVESTIMET STRATEGJIKE;

Për më shumë informacion, katalogun e gjeni online në faqen tonë zyrtare www.aida.gov.al në rubrikën <Publikime> / Link: <https://aida.gov.al/wp-content/uploads/2024/12/Square-Brochure-Investimet.pdf>

Botime

Udhëzues për Prodhuesit dhe Eksportuesit e Vajit të Ulliri në Shqipëri AIDA dhe Programi i Mbështetjes së Shoqatave Rurale kanë publikuar një udhëzues të ri gjithëpërfshirës që do t'ju ndihmojë të hyni me sukses në tregjet ndërkombëtare me vlerë të lartë.

Ky udhëzues, mbështetur nga Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC) përmes projektit RisiAlbania dhe zbatuar nga Helvetas, ofron praktikat më të mira për prodhimin dhe eksportin e vajit të ullirit. Qëllimi është të përmbushni standardet e cilësisë që kërkohen nga tregjet premium, duke e bërë vajin e ullirit 'Made in Albania' një produkt të kërkuar globalisht– Link: https://aida.gov.al/wp-content/uploads/2024/07/GUIDE_Vaji-i-Ullirit-1.pdf

Invest in Albania – Broshurë gjeneraliste me informacione mbi klimën e investimeve në vend. Shumë praktike dhe tërheqëse me informacione dhe ngjyra të gjalla. Link: https://aida.gov.al/wp-content/uploads/2024/01/AIDA_Investors_Brochure_Finale.pdf

Zgjidh të Vendit – është një broshurë që i është dedikuar produkteve Made in Albania. Kjo broshurë erdhi pas aktivitetit të muajit maj. Qëllimi i eventit ishte përfshirja e produkteve vendase në menutë e hoteleve dhe restoranteve, si edhe në politikën promovuese tek turistët e huaj. Link: <https://aida.gov.al/wp-content/uploads/2024/05/Zgjidh-te-Vendit.pdf>

FI NORTH AMERICA 2024 – Broshura e dedikuar për Panairin Amerikan Fi North America, AIDA bashkë me International Trade Center (ITC) dhe Sëiss Import Promotion Programme Albania (SIPPO), realizoi broshurën e dedikuar të sektorit të Bimëve Mjekësore Aromatike dhe të Vajit të Ullirit, që do të jenë pjesëmarrëse në panair. Link: <https://aida.gov.al/wp-content/uploads/2024/10/FI-North-America-Trade-Fair-2024-Final-1.pdf>

MOMAD 2024 – Broshurë e dedikuar posaccërisht për Panairin Momad ku AIDA mori pjesë bashkë me 4 kopmani shqiptare. Ky panair u organizua dhe po ashtu botimi i dedikuar për të në bashkëpunim me Sëiss Import Promotion Program (SIPPO). Link: <https://aida.gov.al/wp-content/uploads/2024/09/MOMAD-brochure-finale.pdf>

BIOFACH 24 Broshura është një publikim i dedikuar për Panairin e Bimëve Mjekësore dhe Arkomatike. Broshura ka në përmbajtje një info të shkurtër mbi Agjencinë, mbi kompanitë që merrnin pjesë në Panair dhe mbi sektorin e bimëve medicinale dhe aromatike në vendin tonë. Kjo broshurë ka qëllimin t'i vijë në ndihmë gjithë rrjetit të profesionistëve por edhe investitorëve potencialë. Për këtë panair u organizua dhe po ashtu botimi i dedikuar në bashkëpunim me Sëiss Import Promotion Program (SIPPO). Linku ku mund të gjendet broshura. Link: <https://aida.gov.al/wp-content/uploads/2024/02/BIOFACH-24-brochure.pdf>

Leaflet informues për Programin e Mbështetjes për Zhvillimin e Biznesit me Fonde për Vitin 2024. Ky botim synonte të informonte gjithë NMVM shqiptare për shpalljen e fondeve në ndihmë të tyre nga buxheti i shtetit dhe kushtet, mundësitë dhe afatet e aplikimit. Linku: https://aida.gov.al/wp-content/uploads/2024/07/Fondet-2024_Web.pdf

Po ashtu janë relaizuar edhe 12 ditare, secili ditari përmbledh aktivitetet kryesore të muajit dhe është botim periodik mujor. Qëllimi i këtyre botimeve është informimi dhe qarkullimi i informacionit për të gjitha palët. Njoftimi për publikimin e ditarit gjendet gjithashtu edhe në rrjetet sociale të institucionit. Linku ditari mujor:

Mars
<https://aida.gov.al/wp-content/uploads/2024/04/AIDA-Ditari-Mujor-2.pdf>
Prill
<https://aida.gov.al/wp-content/uploads/2024/05/AIDA-Ditari-Mujor-04.2024.pdf>
Maj
https://aida.gov.al/wp-content/uploads/2024/06/AIDA-Ditari-Mujor_05.2024.pdf

Qershor

<https://aida.gov.al/wp-content/uploads/2024/07/AIDA-Ditari-Mujor.pdf>

Korrik

<https://aida.gov.al/wp-content/uploads/2024/07/AIDA-Ditari-Mujor-2.pdf>

Gusht

<https://aida.gov.al/wp-content/uploads/2024/09/AIDA-Ditari-Mujor-3.pdf>

Shtator

https://aida.gov.al/wp-content/uploads/2024/10/AIDA-Ditari-Mujor_09.pdf

Tetor

<https://aida.gov.al/wp-content/uploads/2024/11/Ditari-muaj-Tetor.pdf>

Nëntor

<https://aida.gov.al/wp-content/uploads/2024/12/Ditari-muaj-Nentor-1.pdf>

Dhjetor

<https://aida.gov.al/wp-content/uploads/2025/01/Ditari-muaj-Dhjetor.pdf>

AIDA NË AKTIVITETE

Aktivitetet që AIDA ndërmerr, qofshin ato të drejtuara ndaj bizneseve vendase apo atyre të huaja, kanë për qëllim kryesor nxitjen e zhvillimit ekonomik përmes forcimit të sektorit privat dhe krijimit të një klime sa më të favorshme për investime. Në funksion të këtij misioni, AIDA organizon vazhdimisht takime, sesione informuese, panairë dhe iniciativa të tjera të ngjashme, të cilat shërbejnë si ura komunikimi mes bizneseve dhe institucioneve shtetërore, duke i pajisur sipërmarrjet me informacionin dhe mbështetjen që u nevojitet për të rritur kapacitetet e tyre. Për bizneset shqiptare, këto aktivitete janë një mundësi reale për të fituar njohuri mbi tregjet ndërkombëtare, për të gjetur partnerë të rinj, për të promovuar produktet dhe shërbimet e tyre, si dhe për të eksploruar mundësi eksporti. Ndërsa për investitorët e huaj, AIDA ofron një platformë të strukturuar ku ata mund të njihen nga afër me potencialin ekonomik të Shqipërisë, me sektorët prioritarë për investim dhe me avantazhet konkurruese që vendi ofron. Në këtë mënyrë, AIDA jo vetëm që mbështet zhvillimin e bizneseve ekzistuese, por gjithashtu luan një rol kyç në tërheqjen e investimeve të reja dhe në ndërkombëtarizimin e ekonomisë shqiptare.

Gjatë vitit 2024, AIDA ka zhvilluar një cikël të plotë dhe të strukturuar aktiviteteve të fokusuara në mbështetjen e investimeve, promovimin e produkteve shqiptare dhe forcimin e bashkëpunimit ekonomik ndërkombëtar. Ky cikël ka përfshirë organizimin e misioneve tregtare jashtë vendit, pjesëmarrjen në panairë ndërkombëtare, zhvillimin e tryezave të rrumbullakëta me sektorë të ndryshëm prodhues dhe investitorë, si dhe aktivitete informuese në nivel vendor për ndërmarrjet mikro, të vogla dhe të mesme (NMVM). Nisma “Investors Support Days” shënoi një bosht qendror të këtij cikli, duke mundësuar takime të drejtpërdrejta me investitorë të huaj dhe partnerë strategjikë, ndërsa pjesëmarrjet në panairë dhe evente ndërkombëtare shërbyen për të promovuar potencialet konkurruese të Shqipërisë në tregje të reja. Gjithashtu, organizimi i forumeve dhe trajnimeve të dedikuara për bizneset vendase krijoi ura konkrete bashkëpunimi mes sektorit publik dhe atij privat. Ky cikël aktiviteteve është ndërtuar mbi një qasje proaktive, duke garantuar vazhdimësi, përfaqësim cilësor dhe ndikim të drejtpërdrejtë në përmbushjen e objektivave të AIDA-s për vitin 2024.

Disa nga aktivitetet më të rëndësishme mund të përmendim:

- 4 dhjetor 2024; në zyrat e Agjencisë, AIDA ka përmbyllur me sukses nismën Investors Support Days. Ky aktivitet synoi krijimin e urave të reja të bashkëpunimit, lehtësimin e procesit të investimeve dhe të promovojë potencialet e Shqipërisë në sektorë kyç si turizmi, energjia, bujqësia dhe teknologjia.
- 3 dhjetor 2024; në zyrat e Agjencisë, Nënshkrimi i Memorandumit të Mirëkuptimit me Agjencinë Malazeze të Investimeve. Ky zotim synon bashkëpunimin mes dy vendeve.
- 26 nëntor 2024; AIDA organizon misionin e parë tregtar në Varshavë, Poloni. Ky mision kishte si qëllim identifikimin e partnerëve polakë dhe tregjeve të reja për kompanitë shqiptare, duke krijuar mundësi të reja për bashkëpunim ekonomik midis dy vendeve.

- 21 nëntor 2024; Shqipëria dhe Emiratet e Bashkuara Arabe Forcojnë Marrëdhëniet Ekonomike në Forumin e Biznesit. Ky aktivitet synon konsolidimin e marrëdhënieve për projekte të reja.
- 19 nëntor 2024; AIDA bëri bashkë sot investitorët hungarez në Shqipëri, në kuadër të nismës Investors Support Days. Ky event shënoi një hap të rëndësishëm drejt forcimit të marrëdhënieve ekonomike mes Shqipërisë dhe Hungarisë.
- 14 nëntor 2024; Takimi në kuadër të nismës Investors Support Days, me investitorët austriakë dhe përfaqësues nga Ministrinë dhe Ambasada Austriake Tiranë.
- 5 nëntor 2024; Në vijim të nismës Investors Support Days, u mbajt takimi i pestë me investitorët francez në Shqipëri.
- 4 nëntor 2024; AIDA, pjesëmarrëse në datat 6 – 9 Nëntor në edicionin e 30-të të Panairit Ndërkombëtar të Tiranës, në Pallatin e Kongreseve.
- 31 tetor 2024; AIDA organizoi pjesëmarrjen me stendë në “Panairin e Përbërësve të Ushqimit” (Food Ingredients North America) të Amerikës së Veriut
- 25 tetor 2024; AIDA mbledh në tryezë aktorët më të rëndësishëm lidhur me Turizmin në Shqipëri. Duke bërë së bashku me aktorët e turizmit nga sektori publik dhe privat, agjencia organizoi tryezën e diskutimi mbi sektorin e turizmit, duke u fokusuar në sezonin e fundit turistik.
- 24 tetor 2024; AIDA mirëpriti, “Angel Investors” dhe “Venture Capitalist” nga Tirana Slush’D.
- 18 October 2024; AIDA “Investor Support Day,” bashkoi investitorët italianë, për të diskutuar sfidat dhe mundësitë me të cilat ata ndeshen në Shqipëri.
- 4 shtator 2024 në AIDA u zhvillua një takim i rëndësishëm për tërheqjen e investitorëve potencialë nga Japonia. Ky takim synon të forcojë lidhjet ekonomike dhe të sjellë përfitime të ndërsjellta mes dy vendeve.
- 2 gusht 2024; Takim informues në qarkun Fier dhe Vlorë në kuadër të thirrjes për mbështetje me fonde për ndërmarrjeve Mikro, të Vogla dhe të Mesme (NMVM)
- 31 korrik 2024; Takim informues në qarkun Poradec dhe Korçë në kuadër të thirrjes për mbështetje me fond për ndërmarrjeve Mikro, të Vogla dhe të Mesme (NMVM)
- 24 korrik 2024; AIDA pret në takim investitorët gjermanë. Qëlimi i takimit ishte shpалosja e mundësive të investimeve, klimës së biznesit dhe infomimit mbi shërbimet që AIDA ofron për investitorët
- 24 korrik 2024; Takim informues në qarkun Shkodër në kuadër të thirrjes për mbështetje me fond për ndërmarrjeve Mikro, të Vogla dhe të Mesme (NMVM)
- 22 korrik 2024; AIDA dhe EU for Innovation organizuan një ngjarje të rëndësishme për të eksploruar mundësitë e Horizon Europe.
- 18 korrik 2024; Sesioni i parë Informues në AIDA me përfaqësues të subjekteve të qarqeve Tiranë dhe Durrës Në kuadër të thirrjes për mbështetjen dhe zhvillimin e Ndërmarrjeve Mikro, të Vogla dhe të Mesme (NMVM).
- 10 korrik 2024; në AIDA aktiviteti përmbyllës i projektit “Aftësi për Punësim të Qendrueshëm dhe Rritje Ekonomike Gjithëpërfshirëse të Rajonit Ndërkufitar të Shqipërisë dhe Malit të Zi – Aftësi për Punësim Shqipëri – Mal i Zi”.
- 1 korrik 2024; në Vizitë Studimore për Promovimin e Investimeve, u mbajt në Gdansk dhe Varshavë, Poloni.
- 13-15 shtator 2024; Shqipëria merr pjesë në #MOMAD24, një nga panairët më të rëndësishme të modës në Evropë. AIDA prezantoi sektorin në rritje të veshjeve dhe këpucëve në Shqipëri. Madrid, Spanjë.
- 24 maj 2024; AIDA organizoi eventin “Zgjidh të Vendit”, duke bërë bashkë aktorët e biznesit dhe politikbërësit. Qëllimi i eventit ishte përfshirja e produkteve vendase si edhe në politikat promovuese tek turistët e huaj.
- 16-18 Maj 2024; AIDA ishte pjesëmarrëse në panairin “Agro Tech & Natural Expo 2024”, me stendë së bashku me 10 kompani prodhuese, gjatë tre ditëve të panairit.
- 30 prill 2024; Tryezë e rrumbullakët me prodhuesit e produkteve “Made in Albania” të sektorëve të Vajit të Ullirit, Mjaltit dhe Përpunimit të Qumështit



- 24-26 prill 2024; AIDA ishte pjesëmarrëse në panairin “Ditët e Bujqësisë 2024”, që u zhvillua në Lushnje.
- 25 prill 2024; AIDA, në përmbushje të shërbimit të përkujdesjes ndaj investitorëve, zhvilloi Tryezën e rrumbullakët me aktorët e sektorit Automotiv.
- 23 prill 2024; AIDA zhvilloi tryezën e rrumbullakët me prodhuesit e produkteve “Made in Albania” të sektorit “Lëkurë-Këpucë”.
- 19 prill 2024; AIDA organizoi Tryezën e rrumbullakët me prodhuesit e sektorit të verës
- 27 mars 2024 (AIDA), në bashkëpunim me Ambasadën e Republikës Çeke në Shqipëri dhe Ministrinë për Evropën dhe Punët e Jashtme, organizuan më datë 26 mars 2024, Forumin e Biznesit Shqipëri – Çeki.
- 21 mars 2024; AIDA në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Pronësisë Industriale organizuan tryezë diskutimi me temë “Si të rrisni vlerën e biznesit tuaj përmes pronësisë industriale”.
- 13-16 Shkurt 2024; Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve (AIDA), në bashkëpunim me Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Qendrën Ndërkombëtare të Tregtisë në Shqipëri (ITC) dhe mbështetjen e Programit Zvicerian të Promovimit të Importeve (SIPPO), organizuan Pavionin e Shqipërisë në një nga panairët më të mëdhenj të ushqimit organik dhe bimëve aromatike & medicinale “BIOFACH 2024”.

BURIMET NJERËZORE DHE BUXHETI

Menaxhimi i Burimeve Njerëzore

Agjencia Shqiptare për Zhvillimin e Investimeve (AIDA), gjatë vitit kalendarik 2024, në bazë të ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar dhe Vendimit nr. 1, datë 25.03.2019 “Për një ndryshim në vendimin nr.2, datë 04.01.2011 “Për miratimin e statutit të Agjencisë Shqiptare të Zhvillimit të Investimeve”, ka ndërmarrë procedurat e nevojshme për rekrutimin e stafit sipas vakancave të rezultuara.

Konkretisht gjatë këtij viti janë rekrutuar 8 (tetë) punonjës dhe janë larguar:

- Me dorëheqje 6 (gjashtë) punonjës;

Gjithshtu me Vendimin e Bordit Drejtues të AIDA-s nr. 1, datë 08.11.2024 (nr.1749 prot., datë 08.11.2024) “Për disa ndryshime në vendimin nr. 3, datë 17.06.2019 të Bordit Drejtues “Për miratimin e niveleve të pagave dhe të organikës të Agjencisë Shqiptare të Zhvillimit të Investimeve (AIDA)” është miratuar struktura e re e AIDA-s.

Struktura e re ka rikompozuar përbërjet e drejtorive, konkretisht është shkruar Drejtoria e Koordinimit dhe është krijuar Drejtoria e Investimeve Strategjike. Ndërkohë ka patur shtim të numrit të specialistëve në përbërjen e disa strukturave dhe shtim të sektorëve, konkretisht sektori i after care nga një sektor është kthyer në drejtori me një sektor të shtuar në kuadër të procesit të kërkimit dhe zhvillimit si detyrë tashmë e ngarkuar mbi këtë njësi.

Drejtoria e Shërbimeve Mbështetëse nga një strukturë horizontale është ndryshuar duke e ndarë me dy sektor përbërjen e saj, konkretisht reformatimi përfshinë identifikimin e sektorit të financës të ndarë nga sektori i burimeve njerëzore dhe shërbimeve mbështetëse, duke shtuar përgjegjës sektori për burimet njerëzore dhe shërbimet. Gjithashtu stafi mbështetës i nevojshëm i cili mungonte si nëpunës informacioni dhe nëpunës magazine është përfshirë në përbërjen e këtij sektori.

Theksojmë se edhe gjatë këtij viti, AIDA, ndryshe nga viti 2022, nuk ka punësuar asnjë student ekselence në kuadër të nismës “Gati për Shqipëri” dhe nuk ka patur as punonjës me kontratë jashtë organikës. Gjatë vitit 2024, punonjësit e AIDA-s kanë rritur kapacitetet dhe aftësitë duke marrë pjesë në trajnime me tematika si më poshtë:

- "Market Research" GIZ
- "Train the Trainers - ITC Trade and Market Intelligence" ITC
- “Permirësimi i Promovimit të Eksporteve për SME-te në Shqipëri përmes mbështetjes organizative të AIDA-s” GIZ

Në fund të vitit, u bë dhe identifikimi i fushave të cilësuar si prioritare për trajnim nga stafi i cili u përcoll tek ASPA dhe INSTAT.

Burimet e financimit gjatë vitit 2024

AIDA, në zbatim të Ligjit nr. 97/2023 “Për buxhetin e vitit 2024”, i ndryshuar, ligjit nr. 9936, datë 26.08.2008 “Për sistemin e menaxhimit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, të udhëzimit nr. 9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, të udhëzimit nr.14, datë 30.05.2023 “Për Procedurat Standarde të Monitorimit të Buxhetit në Njësitë e Qeverisjes Qendrore”, ligjit nr.10303, datë 15.07.2010 “Për krijimin dhe funksionimin e Agjencisë Shqiptare të Zhvillimit të Investimeve”(AIDA), si dhe VKM nr. 846, datë 26.12.2024, gjatë periudhës raportuese janar – dhjetor 2024, ka administruar dhe menaxhuar fondet e vëna në dispozicion nga 2(dy) burime:

A. Buxheti i Shtetit në masën **249,423,300 lekë**, ku përkatësisht në masën 195,193,300 lekë për shpenzime korrente lidhur me objektin e veprimtarisë së AIDA-s, konkretisht;

- Promovimi i Shqipërisë si destinacion investimesh dhe shërbimet e kujdesit ndaj klientit;

- Grante për mbështetjen e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme,

dhe 54,230,000 lekë për shpenzime për investime me kapital të brendshëm.

Fondet në fjalë gjatë periudhës raportuese kanë pësuar këto shtesa dhe pakësime:

- Me shkresën e Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit (MEKI) me nr. 3499/1 prot., datë 28.03.2024, protokolluar këtu me nr. 506, datë 02.04.2024, “Mbi detajimin e fondit të veçant”, është shtuar fondi i llogarisë ekonomike 606 0000 në masën 120,000 lekë.
- Me shkresën e Ministrisë së Financave me nr. 5662/1 prot., datë 08.05.2024 është miratuar saktësimi i llogarisë ekonomike të fondeve të akorduara në 4 (katër) projektet e investimeve në masën 51,830,000 lekë, nga llogaria 230 0000 në llogarinë 231 0000.
- Me shkresën e Ministrisë së Financave me nr. 10356/1 prot., datë 07.08.2024, është përcjellë miratimi i rialokimit të fondeve, konkretisht, shtuar llogaria 602 në masën 4,000,000 lekë, pakësuar llogaritë 600 0000 dhe 601 0000 në masën 2,000,000 lekë/seicila.
- Me AN nr.3, datë 28.08.2024, shtuar llogaria e shpërnimeve për paga 600 0000 në masën 7,000,000 lekë, fonde të cilat do shërbenin për stafin e ri të AIDA-s sipas project propozimit për ristrukturimin e AIDA-s.
- Me shkresën e Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit me nr. 1498 prot., datë 20.09.2024, është përcjellë miratimi i shtimit të fondeve në llogarinë 602 në masën 7,000,000 lekë.
- Me shkresën e Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit me nr. 11514/2 prot., datë 30.09.2024, është përcjellë miratimi i rialokimit të fondeve për projektet e mbështetjes financiare brenda llogarinë 231, Konkretisht, projektet për Inovacioni, Start Up dhe Biznesin Kreativ janë pakësuar në masën totale prej 14,000,000 lekë dhe ky fond ka shkuar për Projektin e Konkureshmërisë.
- Me shkresën e Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit me nr. 10993/3/1 prot., datë 29.10.2024, është përcjellë miratimi i rialokimit të fondeve fondin e veçant për AIDA-n, konkretisht pakësimi i masës prej 120,000 lekë, për sa mos përdorur gjatë vitit 2024.
- Me AN nr. 5, datë 19.12.2024, është pakësuar:
 - a) Llogaria 600 (fondi i pagave) në masën 14,000,000 lekë, pasi për shkak të miratimit në muajin dhjetor 2024 të ndryshimeve në organikën e re të AIDA-s rezultoi e pamundur rekrutimi i stafit të ri;
 - b) Llogaria 604 për mbështetjen me grante të NVM-ve, prej 1,800,000 lekë (vlëra për tu përfituar si grant i një prej NVM-ve që u tërhoq nga zbatimi i marrëveshjes me AIDA-n duke e lënë fondin të papërdorur);
 - c) Llogaria 231 parashikuar për investime me kapital të brendshëm në masën 2,770,000 lekë për projektin “TVSH për projektet me financim të huaj”, e cila lidhet me fondin që përdoret për financimet e huaja ku TVSH rimbursohet nga shteti në rast se gjatë zbatimit të aktiviteve gjenerohen shpenzime me këtë përmbajtje;

- Në zbatim të VKM-s nr. 846, date 26.12.2024 "Për dhënien e një ndihme të menjëhershme financiare për punonjësit mbështetës të qeverisjes qendrore", shtuar fondi me 33,300 lekë për dhënien e ndihmës së menjëhershme për 3(tre) punonjësit mbështetës në AIDA.

B. Financim i huaj në masën **8,300,000 lekë** si plan për shpenzime për investime me kapital të jashtëm (projekti Skills for Jobs Albania Montenegro). Gjatë kësaj periudhe raportimi nga donatori është përdorur fondi në masën 2,430,031.75 lekë, ndërkohë për mbajtjen e aktiviteteve referuar projektit janë shpenzuar 3,793,163 lekë.

Me AN nr. 5, datë 19.12.2024, është pakësuar në masën 4,500,000 lekë për projektin “Financim i huaj Skills for jobs Albania Montenegro”, financimi i huaj nga projekti i BE, pasi gjatë zbatimit të projektit kjo shumë e parashikuar për tu arkëtuar nuk gjeti realizim pasi donator nuk arriti të lëvronte transhin e radhës brenda vitit 2024, si pasojë AIDA nuk mundi të vijonte me zbatimin e aktiviteteve të mbetura. Plani i ndryshuar për këtë zë është prej 3,800,000 lekë.


Në përfundim të vitit 2024, rezulton se fondi faktik i parashikuar për AIDA-n është në total në masën 253,190,000 lekë. (249,423,300 lekë financim nga Buxheti Shtetit dhe 3,800,000 lekë Financim i Huaj).

Zbatimi i buxhetit për vitin 2024

- Gjatë vitit 2024, fondet e AIDA-s të akorduara nga Buxheti i Shtetit, janë detajuar për shpenzimet korrente në artikujt 600, 601, 602, 604, 606 dhe 231 në funksion të përmbushjes së objektivave të institucionit. Ky buxhet është detajuar në fillim të vitit dhe më tej është rishikuar gjatë vitit për shkak të nevojave të lindura të përcjella nga njësitë e AIDA-s
- Gjatë vitit 2024, me ndryshimet e bëra në këtë buxhet, u realizuan shpenzimet korrente dhe investimet sipas grafikut të mëposhtëm.

Fondi për paga (artikulli 600) dhe sigurime (artikulli 601) u realizuan përkatësisht në masën 100%. Për sa i përket shpenzimeve korrente, ato u realizuan në masën 99%. Shpenzimet për transfera individësh u realizuan në masën 95% dhe shpenzimet për mbështetje me grante në masën 100%. Ndërkohë këtë vit, ndryshe nga viti i kaluar, AIDA pati realizim të kënaqshëm lidhur me fondet e përcaktuara për investime, të cilat u realizuan në masën 97%.

Më poshtë po ju paraqesim në formë grafike rezultatet e realizimit të buxhetit për vitin 2024



Dokumenta ligjore prodhuar gjatë vitit 2024

Gjatë vitit 2024, DSHM/DFBNJSHM, në kuadër të përmirësimit të akteve rregulluese për proceset e punës në AIDA, si dhe në zbatim të legjislacionit në fuqi, ka punuar për hartimin dhe finalizimin e disa dokumentave si:

- **Regjistri i riskut për AIDA-n**

Në zbatim të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin", i ndryshuar, me urdhër të Drejtorit Ekzekutiv është ngritur Ekipi për Menaxhimin e Riskut i përbërë nga drejtuesit e njësive të AIDA-s, të cilët punuan për hartimin e regjistrit të riskut në realizimin e objektivave të AIDA-s para dhe pas kontrollit.

- **Udhëzimi "Për menaxhimin e aktiveve në Agjencinë Shqiptare të Zhvillimit të Investimeve (AIDA)"**

Në zbatim të Ligjit nr. 10296, datë, 08.07.2010, "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", i ndryshuar; Udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 30, date 27.12.2011, "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", i ndryshuar, u hartua materiali i nevojshëm për mirëadministrimin dhe ruajtjen e aktiveve në AIDA. Konkretisht me Urdhrin nr. 85, datë 08.05.2024 u miratua "Udhëzimin Për menaxhimin e aktiveve në Agjencinë Shqiptare të Zhvillimit të Investimeve (AIDA)."

ANEKSI 1

PROJEKTE KONKRETE TË TRAJTUARA ME LIGJIN E INVESTIMEVE STRATEGJIKE

- PROJEKTE TË MIRATUARA ME LIGJIN E INVESTIMEVE STRATEGJIKE 2016 - 2024
- PROJEKTE TË MOSPRANUARA ME LIGJIN E INVESTIMEVE STRATEGJIKE 2016 - 2024



| Nr. | Emri i Projektit Subjekti Aplikues/ | Sektori | Vlera/ Punësimi | Përshkrimi | Vendndodhja |
|-----|--|---------------------|---------------------------------|--|---------------------------------------|
| 1 | “New Born” MANE TCI shpk K22203004A | Turizëm | € 26,000,000 250 vende pune | Kompleks Turistik Vila dhe Apartamente | Hamallaj, Durrës |
| 2 | “Green Coast 1” GREEN COAST L41329038D | Turizëm | € 52,500,000 250 vende pune | Kompleks turistik Hotel me 100 dhoma 188 Vila 136 apartamente | Palasë, Himarë |
| | | | | Ndërtimi i 2 (dy) strukturave akomoduese turistike, hotel me 5 yje, si dhe kompleks turistik | |
| 3 | “Albpanel” ALB PANEL NGR L61605017K | Bujqësi Industriale | € 15,000,000 300 vende pune | Projekti synon të përdorë lëndë të parë kallamin dhe të prodhojë si produkt final panel MDF | Libofshë, Fier dhe Rremas, Lushnje |
| 4 | “Agrocon” AGROCON ALBANIA shpk L324060240 | Bujqësi | € 5,832,000 120 vende pune | Fermë Bujqësore në S=30 Ha. | Ngurrëz e Vogël, Krutje, Lushnje |
| 5 | “Gone Perivol” (Dulaku) CONCORD INVESTMENT shpk K81602049K | Turizëm | € 32,500,000 200 vende pune | Kompleks Turistik Hoteleri dhe fshat turistik e ambiente shërbimi | Palasë, Himarë |
| 6 | “San Pietro” (Dulaku) CONCORD INVESTMENT shpk K81602049K | Turizëm | € 88,000,000 250 vende pune | Kompleks Turistik Hoteleri me 5 yje, me 500 dhoma dhe fshat turistik e ambiente shërbimi | Gjiri i Lalzit |
| 7 | “Kepi Merli” (Shënediella) BOIKEN SHPK K11718001R | Turizëm | € 78,000,000 263 vende pune | Kompleks Turistik Hotel me 5 yje me 210 njësi hotel me 4 yje me 210 njësi 63 vila të llojeve të ndryshme | Ksamil, Sarandë |
| 8 | “Dhërmi Resort” (Gaz Paja) “Startek” sh.p.k. L22327007K “Ecotech Energy Services” | Turizëm | € 12,140,000 300 vende pune | Kompleks Turistik Hotel me 200 dhoma Kompkes vilash | Dhërmi |
| 9 | “Gas Power Plant Korça” GPP KORÇA L73724004N” (investitor i huaj) | Energji (TEC Korça) | € 349,700,000 123 vende pune | HEC Korça | Korçë |



| | | | | | |
|----|---|---|---|--|---|
| 10 | "White Rocks" EUROCOL J61810018B | Turizëm | € 6,800,000 81 vende pune | Resort Turistik | Dhërmi, sip. 1.91 Ha |
| 11 | Akuaponi hidroponi AQUATIQ SHPK L71320011G | Bujqësi | € 5,1 mln 50 vende pune | Akuaponi – hidroponi | Karavasta , Divjakë 1,3 ha |
| 12 | Planatacion shege, avokado, finger lime. "Agro Iliria Group" | Bujqësi | € 6,627 mln 115 vende pune | Planatacion shege, avokado, finger lime.... | Karavasta, Divjakë 500 ha |
| 13 | "Fabrikë për prodhimin e sistemeve dhe pjesëve elektrike për automobilë" YURA COPERATION ALBANIA | Industri Automotive (Zonë me përparësi zhvillimi) | € 6.459.000 | Fabrikë për prodhimin e pjesëve automotive | Baza e Tubove, Fier |
| 14 | Jala Entertainment Park SOLEIL & SEA SHPK | Turizëm (Kompleks Turistik) | € 67,000,000 620 vende pune | Resort Turistik Hotel me 60 dhoma 60 Vila te tipologjive te ndryshme | Jalë – Vuno, Himarë |
| 15 | "TEDA TIRANË" BASHKIA TIRANË | Zonë e Teknologjisë dhe Zhvillimit Ekonomik | | Realizimi i një Zone të Teknologjisë dhe Zhvillimit Ekonomik | Në në zonën Yzberisht, Gropaj dhe Kashar, Tiranë |
| | | | € 62,000,000 5000-7000 vende pune | Realizimi i një Zone të Teknologjisë dhe Zhvillimit Ekonomik me qëllim tërheqjen e investimeve të huaja dhe teknologjive të reja si dhe teknologjive të informacionit, hapjen e vendeve të reja të punës, të cilat do të krijojnë punë të reja të punës. | Në zonën Yzberisht, Gropaj dhe Kashar, Tiranë |
| 16 | "Kompleks Turizëm Rural Lajthiza LAJTHIZA INVEST | Turizëm | € 20,000,000 200 vende pune | Hotel modern, si dhe një fabrikë të re të ambalazhimit të ujit të pijshëm në shishe. | Fshati Lajthizë, Bashkia Fushë – Arrëz |
| 17 | "TIRANA CITY CENTER" "Shiddi Group" sh.p.k. L92202023J "Al- Shiddi trading company" LTD | Turizëm | 106,850,000 1500 vende pune | Ndërtimi i një investimi kompleks që i përket pjesërisht sektorit strategjik të turizmit me strukturë akomoduese elitare turistike-hotel, apartamente elitare | Tiranë |



| | | | | | |
|----|--|---------|----------------------------------|---|------------------|
| 18 | "Parku me erë" "Biopower Green Energy" sh.p.k. K72405024M "Marseglia Group" SRL CF00695260604 Investitor i Huaj | Energji | € 244,000,000 350 vende pune | Ndërtimi i dy parqeve me erë, të quajtura BPGE1 dhe BPGE2, në kreshtat e dy maleve në Bashkinë e Lezhës, të cilat do të jenë të afta të gjenerojnë 234 MW dhe do të zhvillohet në një sipërfaqe prej 100 HA, në | Bashkia Lezhë |
| 19 | "Hotel Chaonians Deluxe" ILIR TREBICKA L814130130 | Turizëm | € 5,500,000 90 vende pune | Ndërtim i një hoteli me 4 yje, si pjesë e kompleksit turistik të quajtur "Thymus", i cili shtrihet në një sipërfaqe totale prej 0.33 ha, të | Bashkia Himarë |
| 20 | COAST TO COAST SH.P.K. GJIKURIA SH.P.K. K97117201D | Turizëm | € 56,910,000 150 vende pune | Investimi kompleks i përbërë nga 3 hotele dhe vila rezidenciale me sipërfaqe truell 20.9 ha në zonën kadastrale 1730 | Bashkia Himarë |
| 21 | "Green Coast 2" GREEN COAST SH.P.K. L41329038D | Turizëm | € 60,800,000 720 vende pune | Green Coast 2: Ndërtimi i 5 hoteleve me 100 dhoma secili, vila individuale elitë, apartamente, pishina, restorante, bar- | Bashkia Himarë |
| 22 | "Jonian Heaven" "Jonian Heaven Group" sh.p.k. L91404041V Investitor i Huaj | Turizëm | € 78,365,976 819 vende pune | Projekti konsiston në ndërtimin e një kompleksi turistik, me 636 ambiente akomodimi restorante, bare, | Bashkia Konispol |
| 23 | "Marina di Valona" (JV) "marina di valona" sh.p.k. M01324008A | Turizëm | € 105,000,000 1000 vende pune | Projekt i integruar i cili konsiston në zhvillimin e një infrastrukture koncensionare portuale turistike si dhe zhvillimin e njëjësive akomoduese, hoteleri e | Bashkia Vlorë |



| | | | | | |
|----|---|---------|---------------------------------|--|-----------------|
| 24 | "Dreamades Luxury Suites" Tan Gaci AG.TCC SH.P.K. | Turizëm | € 5,556,192 120 vende pune | Projekti parashikon realizimin e zhvillimit të një investimi kompleks, të përbërë nga një | Bashkia Himarë |
| 25 | "Banyan Tree Hotel Resort" Luan Muca DAST SH.A. K81401501G | Turizëm | € 24,184,990 184 vende pune | Resort me disa kate me taraca me kapacitet 184 dhoma (standarde, dupeks, suita dhe vila) si dhe do të ofrojë restorante, bare, pishina, SPA, palestër, salla | Bashkia Himarë |
| 26 | "Fermë akuaponi" AQUATIQ SH.P.K. L71320011G Investitori Huaj | Bujqësi | € 26,000,000 1500 vende pune | Projekti parashikon ndërtimin e një Ferme Akuaponike, me një sistem me dy nivele: | Bashkia Divjakë |
| 27 | "Drymades Beach Resort" BLUE BAY SH.P.K. | Turizëm | € 6,326,000 165 vende pune | Projekti parashikon ndërtimin e 1 hoteli elitare të | Bashkia Himarë |
| 28 | PREMIUM FINANCE INVEST SH.P.K. "Cape of Rodon, Faza 1" L61711009G Investitor i Huaj | Turizëm | € 51,369.455 200 vende pune | Projekti parashikon realizimin e një projekti kompleks. Faza e parë do të përfshijë realizimin e: • një hoteli me 4* me sipërfaqe 26,150 m2 do të ketë 250 dhoma si | Bashkia Durrës |
| 29 | "Delta Falaise Resort & Village Faza 2, 3, 4, 5" Luan Muca | Turizëm | € 154,964,433 200 vende pune | Faza 2, 3, 4, 5 parashikon ndërtimin e vilave individuale rezidenciale, 1 hotel me 5* dhe | Bashkia Himarë |
| 30 | "Silver Sand Resort" IMPERIAL GROUP SH.P.K. | Turizëm | € 52,000,000 80 vende pune | Projekti parashikon realizimin e një kompleksi turistik. 2 Hotele me 5* | Bashkia Shkodër |
| 31 | "Manastir Resort - resort turistik 2, 3 dhe 4 kate me parkime nëntokë" "Alb Star" sh.p.k. | Turizëm | € 28,000,000 180 vende pune | Projekti parashikon ndërtimin e një resorti, që do të ketë në përbërje 1 hotel dhe struktura | Bashkia Sarandë |

| | | | | | |
|----|--|---------------------------|--------------------------------------|---|------------------|
| 32 | "White Roads Hotel" sh.p.k. MO2407023J "White Roads Hotel" | Turizëm | € 10.000.000 100 vende pune | Ndërtimi i një resorti, që do të ketë në përbërje një hotel dhe struktura akomoduese me kapacitet total prej 150 (njëqind e pesëdhjetë) njësisish, | Bashkia Himarë |
| 33 | MEDITERRANEAN WAVE SH.P.K. "Mediterranean Wave" sh.p.k. M11916014A | Turizëm | € 50,409,836 80 vende pune | Projekti parashikon ndërtimin e një kompleksi turistik. Struktura akomoduese do të ketë rreth 250 njësi (përfshi vila hotelerie, studio, apartament hotel), | Bashkia Kavajë |
| 34 | "Marina & Jahtet e Durrësit" "EAGLE HILLS REAL ESTATE DEVELOPMENT (EHRED)" SHPK ME NUIS M11736006U | Turizëm Infrastrukturë | € 2,000,000,000 12,000 vende pune | Projekti i integruar me port turistik dhe struktura akomoduese elitare, rezidenca me standard të lartë dhe shërbime në funksion të tyre. | Bashkia Durrës |
| 35 | "Marina Hills" "Finsec Development" sh.p.k. MO2219014S. Investitor i Huaj | Turizëm | 450,000,000 € 200 vende pune | Kompleks turistik. | Bashkia Kavajë |
| 36 | "Resort turistik me vendndodhje në Gjirin e Lalëzit" "Omnix Albania" shpk K81527005D | Turizëm | € 216,000,000 252 vende pune | Kompleks turistik. Hotel me 5* me 250 dhoma 500 Apartamente dhe Vila | Bashkia Durrës |
| 37 | "Zagroturizëm" shpk L818290010 "Zagroturizëm" | Agro-turizëm | € 5,457,335 85 vende pune | Hotel me 62 dhoma si edhe një sërë mjedisesh të tjera çlodhëse, rekreative e | Bashkia Tepelenë |
| 38 | Green House Korça Resort | Turizëm | 18 mln Euro | Hotel me 5 yje me 94 dhoma | Bashkia Korçë |
| 39 | Eralb Invest 2 shpk Investitor i Huaj | Energji | 1.2 miliard Euro | Park me Erë dhe park Fotovoltaik | Bashkia Tropojë |
| 40 | The Cliffs of Tirana Adriatic Resorts LLC sha Investitor i Huaj | Turizëm dhe kazino | 197 milion Euro | Hotel me 5 yje me 250 dhoma dhe 60 njësi apartamentesh; Kazino | Bashkia Tiranë |



| | | | | | |
|----|--|---------|-------------------------------------|--|------------------------|
| 41 | Dajti Express Resort Dajt Express sh.a | Turizëm | 12 milion Euro 84 vende pune | Rijetëzim i ish-kampit të Pionierëve dhe 12 vileta druri | Bashkia Tiranë |
| 42 | Dukagjini Resort Dukagjini Group shpk | Turizëm | 70.2 milionë Euro 218 vende pune | Resort Turistik | Bashkia Lezhë |
| 43 | ATARA RESORT & VILAS LUKOVA BAYSIDE HOTEL & SPA SHPK DHE TO27 CONSTRUCTION SHPK | Turizëm | 50,000,000 Euro 200 vende pune | Resort Turistik | Bashkia Himarë |
| 44 | “NDËRTIM VRESHTI, KANTINË & AGROTURIZËM X ONE shpk | Turizëm | 5,000,007 Euro 80 vende pune | Resort Turistik | Bashkia Lezhë |
| 45 | PROJEKT ME POTENCIAL STRATEGJIK GERHOTI VILLAGE KUMI KONSTRUKSION SHPK | Turizëm | 60,000,000 Euro | Resort Turistik | Bashkia Gjirokastrë |
| 46 | BOGA VALLEY RESORT Boga Valley Resort shpk | Turizëm | 5,100,000 Euro 90 vende pune | Resort Turistik | Bashkia Malësi e Madhe |
| 47 | LËKURËSI TDT Partners shpk dhe Techno ALB shpk | Turizëm | 447,100,000 Euro 150 vende pune | Resort Turistik | Bashkia Sarandë |
| 48 | RESORT TURISTIK ISHULLI I SAZANIT ATLANTIC INCUBATION PARTNERS | Turizëm | € 1,438,158,800 1000 vende pune | Resort Turistik | Bashkia Vlorë |
| 49 | VERTIGO FREE ZONE – DURRËS INDUSTRIAL PARK VERTIGO SHPK NUIS K813095180 | TEDA | € 15,660,300 500 vende pune | TEDA | Bashkia Shijak |



| Nr. | Emri i Projektit Subjekti Aplikues/ | Sektori | Vlera/ Punësimi | Përshkrimi | Vendndodhja |
|-----|--|-------------------------|------------------------------------|---|-----------------|
| 1 | "Adriatica Holding" shpk L71313025K "Kultivimi i karkalecit të detit, në Karavasta, Divjakë, zk.nr.2085" | Bujqësi/ agrikulturë | € 4.2 mln | "Ferme për prodhimin e karkalecit të detit të llojit 'Penaeus Monodon (Giant Tiger Praën)'" | Bashkia Divjakë |
| 2 | "South Coast Development" L71626018J "Krorëz Resort" | Turizëm | € 110.000 600 vende pune | Turizëm Hotel + Vila | Bashkia Himarë |
| 3 | "Novosele Photovoltaic Power Plant" sh. L61709021P "Fotovoltaik energjitik 50 MËAC, Novoselë" | Energji | € 84.782.706 503-784 vende pune | Impiant gjenerues i energjisë elektrike fotovoltaike | Bashkia Vlorë |
| 4 | "Mane TCI" K22203004A "Vala Mare II" | Turizëm | € 64.162.910 200 vende pune | Struktura turistike, Vila dhe apartamente | Bashkia Durrës |
| 5 | "Concord Investment" sh.p.k. K81602049K "Saranda Marina Resort & Senior Housing" | Turizëm | € 26.125.000 | Kompleks turistik | Bashkia Sarandë |
| 6 | "Millenium International" L41411035H "Poro Vlorë" | Bujqësi/ akuakulturë | € 21.081.700 148 vende pune | Kompleks turistik | Bashkia Vlorë |
| 7 | "Mabetex Group" sh.p.k. "Divjaka Resort Albania" | Turizëm | € 954,700,000 4900 vende pune | Resort turistik | Bashkia Divjakë |

| | | | | | |
|----|---|-------------------------|---|---|---------------------------------------|
| 8 | "Vortek" sh.p.k K117080040 "Best Duty Free" sh.p.k. K01621002N "Beryl Resort" | Turizëm | € 15.519.970 165 persona | Resort Turistik | Bashkia Kavaje |
| 9 | "Adriatica Holding" shpk L71313025K "Kultivimi i karkalecit të detit, në Karavasta, Divjakë, zk.nr.2085" | Bujqësi/ agrikulturë | € 4.2 mln | Ferme për prodhimin e karkalecit të detit | Bashkia Divjakë |
| 10 | "JONIAN HEAVEN GROUP" SH.P.K. "Jonian Heaven" | Turizëm | € 78,000,000 443 vende pune | Dy hotele respektivisht, me 280 dhoma dhe 84 dhoma, restorante, bare, një kazino, salla konferencash | Fshati Vrinë, Bashkia Konispol |
| 11 | "VORTEK" SH.P.K. & "BEST DUTY FREE" SH.P.K. "Beryl Resort" | Turizëm | € 16,804,112 118 vende pune | Resort turistik | Bashkia Kavajë |
| 12 | "FAFA RESORT" SHPK | Turizëm | € 63,126,676 Euro 550 vende pune | Resort turistik, me një hotel me njëmbëdhjet ë kate, katër godina apartamente sh dhe pesë vila individuale me një kapacitet total prej 519 dhomash | Fshati Golem, Bashkia Kavajë |
| 13 | "PËR NDËRTIMIN DHE MIRËMBAJTJEN E ZONËS SË TEKNOLOGJISË DHE ZHVILLIMIT EKONOMIK (TEDA) SPITALLË DHE INSTALIMIN E PARKUT FOTOVOLTAIK ME FUQI 40.54 MËP, DURRËS" "NOA ENERGY TRADE" SHPK, ME NUIS/NIPT: L42203031A | Energji | € 30,000,000 | TEDA DURRES | Bashkia Durrës |

| | | | | | |
|----|--|---------|----------------------|--------------------------------------|---|
| 14 | <p>“IMPIANTI AGRIVOLTAIK 120 MW”</p> <p>“NATYRE ENERGY” SHPK, ME NUIS: L72220033M”</p> | Energji | € 109,483,772 | Impiant fotovoltak | Bashkia Lushnjë |
| 15 | <p>“SOLAR ENERGY CELLS 300 MWP”</p> <p>SOLAR ENERGY CELLS SHPK, ME NUIS/NIPT: M26422204I</p> | Energji | € 175, 944,000 | Park Fotovoltak | Bashkia Vlorë |
| 16 | <p>“IMPIANT FOTOVOLTAIK ME FUQI 70MWP”,</p> <p>DH SOLAR PARK, ME NUIS/NIPT: M21809033P”</p> | Energji | € 31,000,000 | Park Fotovoltak | Bashkia Pogradec |
| 17 | <p>“IMPIANT FOTOVOLTAIK 150 MWP (AC) AGA SOLAR PARK”</p> <p>“AGA SOLAR” SHPK, ME NUIS/NIPT: M11415029E</p> | Energji | € 176,479,000 | Park Fotovoltak | Fshati Darëzezë e Re, Bashkia Fier |
| 18 | <p>“EURON SOLAR PV – 50 MW”</p> <p>“EURON” SHPK, ME NUIS/NIPT: J71317002N”</p> | Energji | € 37,500,000 | Park Fotovoltak | Bashkia Fier |
| 19 | <p>“BELSHI SOLAR PARK”</p> <p>“VERBUND GREEN POWER ALBANIA” sh.p.k., ME NUIS/NIPT: M21423032T</p> | Energji | € 60,000,000 | Park Fotovoltak | Bashkia Belsh |
| 20 | <p>“PARKU AGRIVOLTAIK FIER 170 MWP”</p> <p>“FIER HELIOS SHPK” ME NUIS/NIPT M22325031U</p> | Energji | € 150,000,00 0 | Park Fotovoltak | Bashkia Fier |
| 21 | <p>“HELIOS GREEN ENERGY”</p> <p>HELIOS GREEN ENERGY SHPK, ME NUIS/NIPT: M26423202U</p> | Energji | € 66,024,000 | Park Fotovoltak | Bashkia Selenicë |
| 22 | <p>PËR ANULIMIN E VENDIMIT TË KOMITETIT TË INVESTIMEVE STRATEGJIKE NR. 2/7, DATË 27.07.2020 DHE VENDIMIT TË KOMITETIT TË INVESTIMEVE STRATEGJIKE NR. 2/10, DATË 04.02.202</p> <p>Al Shiddi Trading Company LTD</p> <p>Shiddi Group sh.p.k, NUIS/ NIPT L92202023J</p> | Turizëm | € 106,850,00 0 | Strukturë turistike akomoduese | Bashkia Tirane |

| | | | | | |
|----|--|---------|--|--|----------------|
| 23 | TEDA ALIEN HOUSE” ALIEN HOUSE SH.A NUIS M32106030E | TEDA | € 87,200,000 190 vende pune | Zonës Teknologjike dhe e Zhvillimit Ekonomik (TEDA) Alien House, | Bashkia Tirane |
| 24 | TIRANA NORTH PARK-FREE ECONOMIC ZONË LAPRAKË TIRANA NORTH PARK FREE ECONOMIC ZONË | TEDA | € 119,995,959 1200- 6000 vende pune | Zone Teknologjike dhe e Zhvillimit Ekonomik (TEDA) | Bashkia Tirane |
| 25 | LUXORY HOTEL GOLEM ADRIATIC LUXURY HOTELS SHPK NUIS M32106030E | Turizem | € 50,000,000 90 vende pune | Strukture hotelerie | Bashkia Kavajë |
| 26 | RODON SHORES RODON GROUP SHPK, NUIS M31914003A | Turizem | € 210.569.670 170 vende pune | Resort Turistik | Bashkia Durres |
| 27 | LIVADH BEACH RESORT XHELUKS KONSTRUKSION SHPK NUIS L02101001A | Turizem | € 17,800,000 80 vende pune | Resort Turistik | Bashkia Himare |
| 28 | KAMPINGU PA EMËR – GURI I LËMUAR KAMPING PA EMËR PEPOSHI KARPEN-KAVAJË SH.P.K. ME NUIS K72701801L | Turizem | € 5,223,868 81 vende pune | Resort Turistik | Bashkia Kavajë |
| 29 | PLAYA Y MAS- HOTEL DHE RESIDENCA, GJIRIN E LLAMANIT LUANI SHPK NUIS J66703045Q | Turizem | € 110,673,253 325 vende pune | Resort Turistik | Bashkia Kavajë |
| 30 | RESORT NË GJIRIN E LLAMANIT CAPITAL B SHPK NUIS L41924002T DHE BEGA-07 SHPK K73312401J | Turizem | € 63,246,500 144 vende pune | Resort Turistik | Bashkia Himare |
| 31 | BLUE BAY RESORT RINIA - 04 SHPK NUIS K52622408F | Turizem | € 24,400,000 100 vende pune | Struktur akomoduese | Bashkia Himare |